



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2022

VENDIM

Nr. 67, datë 23.02.2022

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi mjaft të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Rastet e vëzhguara tregojnë se ajo ka shqyrtuar çështje gjyqësore në fushën civile që lidhen me njohjen e pronës me anë të parashkrimit fitues (shih dokumenti nr. 2), me pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë (shih dosja nr. 3), me marrëdhëniet e punës që lindin nga emërimi (shih dokumentin nr. 3), në të drejtën familjare që lidhet me konfliktet bashkëshortore (shih dosja nr. 5), në fushën e së drejtës penale që merr në mbrojtje rendin dhe sigurinë publike për drejtimin e automjetit në mënyrë te parregullt (shih dosja nr. 2 dhe 4), me pasurinë e personave fizikë dhe juridikë me anë të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën (shih dokumenti nr. 1), me kufizimin e lirisë së personit (shih dosja nr. 1). Gjyqtarja evidenton rastet kur për zgjidhjen e çështjes kërkohën njohuri të posaçme me ekspertë në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknikës (shih dosja nr. 3), kur ekzistenca e veprës penale përcaktohet nga leja nga organi kompetent shtetëror (shih dosja nr. 2 dhe 4), kur dispozita penale është e bardhë dhe për përcaktimin e faktit penal i referohet ligjit të posaçëm (K.Rrugor, shih dosja nr. 2 dhe 4).”*

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik civil apo penal vjen gjithmonë i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes pothuajse në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, familjar, gjykim penal, apo kërkesë me objekt vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale*), rrethanat e fakteve parashtrihen në fillim të pjesës përshkruese - arësyetuese të vendimit, pas parashtrimit të disa rrethanave procedurale dhe si një nën pjesë e titulluar “Rrethanat e çështjes”. Evidentohet analizë e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre apo organi i akuzës¹, por në përputhje dhe i integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Gjyqtarja në nxjerrjen

¹ Shih për më tepër vendimin nr. 378 datë 29.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

e faktit juridik, bazohet jo vetëm në provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, por edhe ato të mara kryesisht nga gjykata nga të tretët konform nenit 223 të K.Pr.Civile apo dhe në kryerjen e akteve ekspertimeve në ato raste kur për zgjidhjen sa më drejtë të çështjes nevojiten njohuri të posaçme². Në të gjitha vendimet gjyqësore konstatohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

-Identifikimi i natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale. Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtarja përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje pronësie, pavlefshmëri titulli juridik, marrëdhënie pune apo përmbushje detyrimi kontraktor, etj*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtëpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj dhe që përbën edhe një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë konform nenit 467 pg 1 gërma “a” e K.Pr.Civile, dhe këtë e pasqyron pothuajse në të gjitha vendimet burim vlerësimi (*si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale*) në pjesën e parë përshkruese arësytuese duke analizuar në mënyrë të detajuar juridiksionin dhe kompetencën e saj (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes është evidentuar pothuajse në të gjitha çështjet e trajtuara, por edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e kërkesave apo situatave procedurale, konstatohet se:

² Shih për me teper vendimin nr. 810 datë 13.07.2015, vendimin nr. 1234 datë 23.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

(i) Në vendimet civile (mosmarrëveshje pronësie, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, përmbushje detyrimit kontraktor, dëmshpërblim që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënies së punës, zgjidhje martesë, etj), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil, ashtu edhe ligjeve organike përkatëse, që kanë lidhje kryesisht me:

- a) *Pavlefshmërinë e titujve ekzekutiv të faturave të energjisë elektrike*,³ ku gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale (nenin 609 të K.Pr.Civile) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, dhe po kështu ligjet e posaçme nr. 8662 datë 18.09.2000 mbi «Përcaktimin e faturës tatimore titull ekzekutiv», apo ligjin nr. 9072 datë 22.05.2003 «Për sektorin e energjisë elektrike» dhe ligjin nr. 10362 datë 16.12.2010 në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi ligjshmërinë apo jo të faturimit të energjisë elektrike të abonentit.
- b) *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*⁴, ku identifikon dhe citon dispozitat ligjore familjare (nenin 1, 50, 132, 133, 146, 155, 161, 192, 197 dhe 201 të K.Familjes) në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve si dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj.
- c) *Zgjidhjen e kontratës së punës*, duke cituar nenin 141 të K.Punës për të përcaktuar mënyrën e përfundimit të kontratës së punës me afat të pacaktuar, nenin 143 të K.Punës në lidhje me respektimin e afatit të njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës si dhe nenin 153 të K.Punës në kuadër të zgjidhjes së çështjes nëse në rastin objekt gjykimi jemi para një zgjidhje të bërë nga ana e punëdhënësit në mënyrë të menjëhershme dhe të justifikuar si dhe pasoja ligjore e kësaj zgjidhje e parashikuar në nenin 155 të K.Punës, nenin 144 dhe 145 në lidhje me dëmshpërblimin për mosrespektim të procedurës dhe shpërblimin për vjetërsi⁵.
- d) *Fitimin e pronësisë me parashkrim fitues*, duke cituar ligjin e zbatueshëm, dispozitën materiale civile (nenin 168 të K.Civil) në funksion të zgjidhjes së çështjes referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, si dhe ligjin e posaçëm nr. 7501/1991 «Për tokën» kur analizon origjinën e pronësisë objekt gjykimi. Citon nenin 170 të K.Civil në lidhje me të drejtën e paditësit për të kërkuar me padi kundrejt atij që e ka të rregjistruar sendin, fitimin e saj me parashkrim fitues dhe si pasojë rregjistrimin e sendit nga organi kompetent shtetëror (personi i tretë në këtë gjykim), dhe nenin 304 -305 të K.Civil në lidhje me ekzistencën e mirëbesimit të posedimit të sendit objekt fitimi pronësie.
- e) *Detyrimet që rrjedhin nga mospërmbushja e marrëdhënieve kontraktore*⁶ duke cituar dhe identifikuar për këtë qëllim si dispozitat e përgjithshme të lindjes së detyrimeve (neni 419, 420 të K.Civil) ashtu edhe dispozitat materiale në lidhje me marrëdhënien juridike të detyrimit konkret dhe pasojat që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimit (neni 698 i K.Civil).

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si më zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së çështjeve dhe kërkesave procedurale. Konkretisht në çështjet në fazën e ekzekutimit,⁷ citimi i dispozitave procedurale civile që kanë lidhje me fazën e ekzekutimit të titujve ekzekutiv (si psh

³ Vendimi nr. 810 datë 13.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁴ Vendimi nr. 579 datë 26.06.2016 dhe vendimi nr. 1206 datë 20.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁵ Vendimi nr. 792 datë 29.07.2014, nr.849 datë 18.07.2016 dhe vendimi nr. 731 datë 17.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

⁶ Vendimi nr. 666 datë 10.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁷ Vendimi nr.301 datë 02.12.2013, vendimi nr. 92 datë 26.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

nenet 609 dhe 611) janë identifikuar si ligj i zbatueshëm material në funksion të zgjidhjes së çështjes në themel dhe jo si dispozita për zgjidhjen e kërkesave procedurale në funksion të gjyqimit. Ndërkohë në raste të tjera konstatohet identifikimi i dispozitave procedurale në lidhje me vendimarrjen mbi kërkesat për shtimin apo saktësimin e objektit të padisë pa ndryshuar shkakun ligjor të saj (*neni 185 i K.Pr.Civile*), për sigurimin e objektit të padisë (*neni 202 e vijues të K.Pr.Civile*), dhe thirrjen e personit të tretë kryesisht nga gjykata (*neni 193 i K.Pr.Civile*), për kalimin procedural të trashëgimtarëve të palës së paditur (*neni 199 i K.Pr.Civile*), etj. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, është disponuar lidhur me kërkesat procedurale në përputhje me faktin, provat dhe dispozitën relevante procedurale përkatëse, dhe në disa raste vendimet e ndërmjetme në lidhje me pranimin apo rrëzimin e këtyre kërkesave janë arsyetuar në mënyrë të qartë dhe koncize në pjesën e parë përshkruese - arsyetuese tek pjesa e rrethanave procedurale. Në arsyetimin e vendimeve citohen dispozitat procedurale civile (*nenet 36/1, 41, 42, 43, 45, 47, 50, 51*), në lidhje me përcaktueshmërinë e juridiksionit dhe kompetencës lëndore dhe tokësore të shqyrtimit të çështjes.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të kodit penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të kodit penal.

- a) Konkretisht, identifikohet neni 135 i K.Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”⁸, neni 291 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”⁹, neni 280 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Prodhim dhe mbajtje e armëve të gjahut”¹⁰, neni 199/a/1 i K.Penal në lidhje me akuzën e «Ndërtimit të paligjshëm».¹¹
- b) Në ato raste kur për cilësimin juridik të veprës penale që i atribuohet të pandehurit dhe me qëllim përcaktimin e përgjegjesisë penale të tij, nevojitet referimi në ligje të tjera organike, identifikohet ligji organik përkatës. Konkretisht në analizën e anës objektive të figurës së veprës penale të «Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt» pa leje drejtimi parashikuar nga neni 291 i K.Penal, gjyqtarja i është referuar edhe ligjit organik Kodit Rrugor në kushtet kur neni 291 i K.Penal përcakton vetëm kategorinë e përgjithshme të mjeteve të qarkullit rrugor, por dispozita penale nuk merr përsipër të përcaktojë në mënyrë shteruese të saktë dhe definitive llojet e mjeteve të qarkullimit rrugor dhe këtë funksion e realizon ligji nr. 8378 datë 22.07.1998 i ndryshuar (Kodi Rrugor) dispozitat e të cilit janë të nevojshme sipas gjykatës për të bërë klasifikimin e mjetit të poseduar nga i pandehuri ashtu edhe të identifikojë llojin e dëshmisë përkatëse që duhet të disponojë i pandehuri.¹² Po ashtu, në analizën e anës objektive të veprës penale të «Ndërtimit të paligjshëm» parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, gjyqtarja identifikon nenin 3 pika 16 dhe 20 e ligjit nr. 107/2014 «Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit» duke qenë se dispozita penale (*neni 199/a/1 i K.Penal*) nuk të referon në mënyrë shteruese të saktë dhe definitive llojet e ndërtimeve pa leje apo të përcaktojë lejen përkatëse.¹³

⁸ Vendimi nr. 378 datë 29.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁹ Vendimi nr. 471 datë 30.10.2014 dhe vendimi nr. 219 datë 26.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

¹⁰ Vendimi nr. 467 datë 27.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹¹ Vendimi nr. 88 datë 03.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹² Vendimi nr. 471 datë 30.10.2014 dhe vendimi nr. 219 datë 26.05.2016 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

¹³ Vendimi nr. 88 datë 03.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

- c) Në çdo rast referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, psh në lidhje me institutin e bashkëpunimit (*nenin 25, 26, 27 e vijues të K.Penal*)¹⁴ në lidhje me individualizimin e dënimit apo edhe aplikimin e alternative të dënimit (*nenet 47, 48, 49, nenet 59 dhe 63 të K.Penal*),¹⁵ dhe dispozitat e dënimit me *gjobë* (*nenin 34 të K.Penal*).¹⁶

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtarja ka referuar në çdo rast, si pjesë e integruar e arsytimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal (*nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës, procedurën e gjykimit të shkurtuar në rastin e pranimit apo edhe mospranimit të saj¹⁷ (*nenet 403 - 406 të K.Pr.Penale*), dispozitat ligjore lidhur me çmuarjen e provave dhe vlerën provuese të tyre (*nenin 152 të K.Pr.Penale*), nenin 388 të K.Pr.Penale për deklarinimin e pafajshëm në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit. Në vendimin me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi¹⁸, gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë interpretuar nga gjyqtarja ndonjë rast konflikt i normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Identifikimi dhe përcaktimi nga gjyqtarja, në mënyrë të qartë i faktit juridik që përbën objektin e gjykimit, orienton mënyrën e paraqitjes së fakteve, analizën e provave dhe analizën ligjore të çështjes në vijim të arsytimit të vendimit, analizë e cila është e ndryshme në bazë të objektit të gjykimit

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.

¹⁴ Vendimi nr. 378 datë 29.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹⁵ Vendimi nr. 471 datë 30.10.2014, nr. 219 datë 26.05.2016, nr. 88 datë 03.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹⁶ Vendimi nr. 467 datë 27.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹⁷ Vendimi nr. 378 datë 29.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

¹⁸ Vendimi nr. 19 datë 23.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi mjaft të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Rastet e vëzhguara tregojnë se ajo ka shqyrtuar çështje gjyqësore në fushën civile që lidhen me njohjen e pronës me anë të parashkrimit fitues (shih dokumenti nr. 2), me pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë (shih dosja nr. 3), me marrëdhëniet e punës që lindin nga emërimi (shih dokumentin nr. 3), në të drejtën familjare që lidhet me konfliktet bashkëshortore (shih dosja nr. 5), në fushën e së drejtës penale që merr në mbrojtje rendin dhe sigurinë publike për drejtimin e automjetit në mënyrë të parregullt (shih dosja nr. 2 dhe 4), me pasurinë e personave fizikë dhe juridikë me anë të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën (shih dokumenti nr. 1), me kufizimin e lirisë së personit (shih dosja nr. 1). Gjyqtarja evidenton rastet kur për zgjidhjen e çështjes kërkohën njohuri të posaçme me ekspertë në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknikës (shih dosja nr. 3), kur ekzistenca e veprës penale përcaktohet nga leja nga organi kompetent shtetëror (shih dosja nr. 2 dhe 4), kur dispozita penale është e bardhë dhe për përcaktimin e faktit penal i referohet ligjit të posaçëm (K.Rrugor, shih dosja nr. 2 dhe 4). Gjyqtarja {...} ka njohuri për parimet themelore të procesit gjyqësor penal e civil, jo vetëm që i përdor gjatë gjykimit ato, por në arsyetimin e vendimit gjenden raste ku ajo iu referohet parimeve në zbatimin e ligjit si: parimin e veprimit të ligjit në kohë (shih dosja nr. 2 dhe 4), parimin e prezumimit të pafajësisë (shih dokumenti nr. 1), parimin e sigurisë juridike (shih dokumenti nr.2), parimin e përgjithshëm të një dyshimi të arsyeshëm (shih dosja nr. 1), parimin e sigurimit të interesit më të lartë të fëmijës (shih dosja nr. 5). Ajo vlerëson dhe i kushton rëndësi dënimit të të pandehurit me burgim dhe pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi, duke aplikuar nenin 59 dhe 63 të K.Penal, për veprën penale të drejtimin të automjetit në mënyrë të parregullt (shih dosjen nr. 2 dhe 4), por masa e dënimit është shumë e ulët, duke cënuar parimin kushtetues të proporcionalitetit. Identifikon rastet, kur duhet përdorur gjykimi i posaçëm apo shkurtuar (shih dokumenti nr. 1 dhe dosja nr. 2 dhe 4). Ajo ka përdorur referenca në vendimet unifikues të Gjykatës së Lartë, të GJEDNJ, të Gj.Kushtetuese dhe*

dispozitave të tyre, duke i cituar ato në fund të faqes (shih dokumentin nr. 1, dhe 3, dosjen nr. 1 dhe 5). Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 3 vendime, nga të cilat 1 vendim është cënuar pjesërisht dhe pushuar çështja për interpretim të gabuar të ligjit penal material (shih dokumenti nr. 1) dhe 2 janë lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe në 1 rast është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë (shih dokumenti nr. 3 dhe dosja nr. 3).”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast citimi i dispozitave është i shoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin teleologjik të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*), por edhe interpretimin gramatikor apo sistematik të normave, dhe duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, nxjerr konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

(i) Në vendimet civile: Përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja:

- a) Interpreton dispozitat ligjore materiale në lidhje me paditë që ngrihen në fazën e ekzekutimit, në mënyrë eksplicite të padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv (*nenin 609 të K.Pr.Civile*) duke përcaktuar funksionin dhe qëllimin e ngritjes së kësaj padie, si dhe rastet se kur mund të kërkohet pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, të gjitha këto në funksion të zgjidhjes së çështjes¹⁹.
- b) Interpreton në mënyrë abstrakte e në vijim mbi provat objekt gjykimi, mënyrën e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues të evokuar nga paditësi (*neni 168 të K.Civil*) mbi kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, për të konkluduar mbi pranimin e padisë dhe fitimin e pronësisë me parashkrim fitues.²⁰
- c) Referuar interpretimit literal të bërë dispozitës materiale (*nenit 143 të K.Punës*), dhe rrethanave të faktit, gjyqtarja arsyeton se mënyra e zgjidhjes së kontratës së punës është ajo në mënyrë të menjëhershme pa respektuar afatin e njoftimit, e për pasojë në lidhje me këtë mënyrë përfundimi referenca ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes orientohet drejt normës materiale nenit 153 dhe 155 të K.Punës për të përcaktuar nëse shkaqet e zgjidhjes e justifikojnë këtë

¹⁹ Vendimi nr. 810 datë 13.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

²⁰ Vendimi nr. 1234 datë 23.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

mënyrë përfundimi të marrëdhënies së punës me paditësin. Gjyqtarja interpreton dispozitën përkatëse (*nenin 153 të K.Punës*) duke analizuar në përputhje me faktet, kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative që të legjitimojnë punëdhënësin që të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me punëmarrësin. Për të përcaktuar që zgjidhja e kontratës është bërë në mënyrë të pajustificuar gjykata interpreton edhe dispozitat e përgjithshme të kontratës së punës dhe më konkretisht nenin 23 të K.Punës mbi rregullimet imperative ligjore të kontratës së punës sipas së cilës në mënyrë të njënashme punëdhënsi nuk mund të ndryshojë kushtet e kontratës së punës. Në lidhje me kërkimin për shpërblimin për vjetërsi në punë, gjyqtarja ndalet tek interpretimi literal i dispozitës (*nenit 145 të K.Punës*) duke përcaktuar edhe dy kushtet ligjore që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative për të përfituar nga shpërblimi për vjetërsi në punë²¹.

- d) Interpreton dispozitën materiale, nenin 132 të K.Familjes në lidhje me shkaqet e zgjidhjes së martesës. Referuar interpretimit literal, gramatikor dhe logjik të dispozitës gjykata arrin në konkluzionin se përmbushen në mënyrë kumulative të dyja kushtet e parashikuara në të, si humbja e qëllimit të martesës dhe pamundësia e vazhimit të jetesës së përbashkët ndërmjet bashkëshortëve pikërisht për shkak të atyre shkaqeve që citohen jo në mënyrë shteruese në nenin 132 të K.Familjes. Interpreton dispozitat materiale në lidhje me zgjidhjen e pasojave ligjore që rrjedhin nga mbarimi i martesës siç është ajo e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe detyrimit për ushqim, të cilat janë pasoja ligjore që nuk lidhen me kërkimet e palëve.²²

(ii) *Në vendimet penale*: Në vendimet penale të analizuara, duke iu referuar natyrës së çështjes, e cila përcakton edhe elementët që duhet të analizohen në aspektin e provueshmërisë së fakti penal, gjyqtarja interpreton normën përkatëse të K. Penal në mënyrë abstrakte, duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete, veçanërisht në çështjet penale të themelit, ku ky interpretim është i domosdoshëm. Interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Kryesisht konstatohet se gjyqtarja interpreton teorikisht normën relevante të K.Penal duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale përkatëse që i atribuohet të pandehurit, dhe në vijim duke e përputhur me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit. Dispozitat e kodit penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale, duke u përqëndruar më tepër në anën objektive të saj.²³ Konstatohet jo vetëm identifikimi, por edhe interpretimi i ligjeve të posaçme në ato raste kur dispozita penale materiale ku të referon fakti penal është një dispozitë blanket, si psh në vendimin nr. 471 datë 30.10.2014 dhe vendimin nr. 219 datë 26.05.2016 duke qenë një dispozitë e bardhë (neni 291 i K.Penal) është referuar në dispozitat e K.Rrugor, nenet 52 dhe 53 të tij, ose në vendimin nr. 88 datë 03.03.2016 në të cilën gjykata për të përcaktuar anën objektive të veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm” i referohet ligjit organik për urbanistikën.

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, evidentohet edhe

²¹ Vendimet nr. 792 date 29.07.2014, nr. 849 datë 18.07.2016 dhe vendimi nr. 849 datë 18.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

²² Vendimi nr. 579 datë 26.06.2016 dhe 1206 datë 20.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

²³ Konstatohet ky interpretim në të gjitha vendimet penale burim vlerësimi.

interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*) ose aplikimin apo jo të alternativave të dënimit (neni 59 dhe 63 të K.Penal.) Në këto raste, gjykata ndalet kryesisht në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri nga një masë dënimi më e ulët apo edhe të një dënimi alternativ të parashikuar në nenin 59 apo 63 të K.Penal.²⁴

- Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale:

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm përsa i përket aspekteve meritore, por edhe atyre procedurale në rastin kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi interpretimit të normës, në drejtim të zgjidhjes së situatave procedurale, të iniciuara nga palët (*kërkesat e palëve*), iniciuara kryesisht ose si domosdoshmëri e procesit të të provuarit.

Në çështjet penale konstatohet se: (i) interpreton nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar sa i përket plotësisht të kushteve ligjore të këtij neni, me pasojë mospranimin e kërkesës²⁵, etj; (ii) Interpreton në mënyrë abstrakte nenin 388 të K.Pr.Penale mbi rastet e pafajësisë duke u përqëndruar në mënyrë të posaçme tek formula e pafajësisë së parashikuar nga neni 388/d i K.Pr.Penale kur nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet;²⁶ (iii) Në vendimin penal me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi,²⁷ gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në lidhje me vlerësimin që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit;

Në çështjet civile (i) Interpreton në mënyrë abstrakte kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për sigurimin e padisë, nenin 202 të K.Pr.Civile në lidhje me kërkesën e palës paditëse.²⁸ (ii) Interpreton nenin 199 të K.Pr.Civile në funksion të kërkesës së palës paditëse për kalimin procedural të palëve të paditura (suksedimi procedural gjatë gjykimit)²⁹, etj

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.

Në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe vendime të GJEDNJ-së*) në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

²⁴ Vendimi nr. 100 datë 09.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

²⁵ Në të gjitha vendimet penale burim vlerësimi të analizuara për efekt të këtij vlerësimi.

²⁶ Vendimi nr. 378 datë 29.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

²⁷ Vendimi nr. 19 datë 23.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

²⁸ Vendimi nr. 810 datë 13.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

²⁹ Vendimi nr. 1234, datë 23.12.2014 i Gjykatës Rrethit Gjyqësor Berat.

- *Gjykimin e shkurtuar*; Konstatohet se nga ana e gjykatës është cituar dhe zbatuar në pranimin ose jo të kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr. 2 datë 29.01.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe standartin kushtetues në lidhje me këtë institut të vendosur në vendimin nr. 4 datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese.³⁰
- *Caktimin e masave të sigurimit*; Gjykata mbështet konkluzionin e saj në ekzistencën e dyshimit të arësyeshem dhe caktimit të masës së sigurimit ndaj personit nën hetim, në përputhje me orientimet e vendimit unifikues nr. 7 datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe vendimet e GJEDNJ-së si Fox, Cambell dhe Hartley vs Mbretërisë së Bashkuar apo Gusinskiy vs Ruisë.³¹
- *Mbi njoftimin e të pandehurve*, si një të drejtë për tu degjuar në procesin penal duke identifikuar për këtë qëllim jo vetëm dispozitat procedurale penale (*nenet 139 e vijues të K.Pr.Penale*) por njëkohësisht edhe vendimet e GJEDNJ-së si psh Sedovic vs Italisë.
- *Instituti e bashkëpunimit*, marrëveshjen si dhe aspektet e anës objektive dhe subjektive që duhet të ekzistojnë për të vlerësuar ekzistencën e saj mes bashkëpunëtorëve, konceptin e marrëveshjes dhe elementët që vlerësohen për të përcaktuar ekzistencën e saj duke identifikuar për këtë qëllim dhe zbatuar në rastin konkret edhe vendimin unifikues nr. 1 datë 26.03.2002 të Gjykatës së Lartë dhe vendimin unifikues nr. 4 datë 15.04.2011 mbi bashkëpunimin në përgjithësi si formë e kryerjes së veprës penale nga ana objektive dhe në veçanti unifikimin e praktikës në lidhje me përgjegjesinë penale të të pandehurit edhe në rastin kur bashkëpunëtorët janë të panjohur.³²
- *Mosrëndimin e pozitës së të pandehurit*, duke cituar për këtë qëllim edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 10.02.2012³³
- *Dëmshtëpërblimin që rrjedh nga marrëdhëniet e punës*.³⁴ Konstatohet se nga ana e gjykatës është cituar dhe zbatuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë korrekte vendimi unifikues nr. 19 datë 15.11.2007 i Gjykatës së Lartë.

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshem në zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur. Gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit siç janë:

- Parimi prezumimit të pafajësisë*, sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale, në nenin 30 të Kushtetutës apo në nenin 6 pg 2 të KEDNJ-së, dhe parimin procedural penal që ka lidhje të drejtëpërdrejtë me përgjegjësinë penale të autorit "*përtej çdo dyshimi të arsyeshem*",³⁵
- Parimin e interesit më të lartë moral dhe material të fëmijëve të mitur*, duke cituar për këtë qëllim nenin 2 dhe 5 të K.Familjes si edhe nenin 3 të Konventës së OKB "*Mbi të drejtat e*

³⁰ Konstatohet identifikimi i vendimit unifikues të sipercituar në të gjitha vendimet penale burim vleresimi.

³¹ Vendimi nr. 19 datë 23.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

³² Vendimi nr. 378 datë 29.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

³³ Në të gjitha vendimet penale të analizuara.

³⁴ Vendimi nr. 792 datë 29.07.201, nr. 849 datë 18.07.2016 dhe vendimi nr. 849 datë 18.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

³⁵ Vendimi nr. 378 datë 29.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

fëmijëve” si dhe Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës dhe të njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Në lidhje me të drejtën e takimit mban në konsideratë edhe *të drejtën për jetë familjare* të sanksionuar në nenin 8/1 të KEDNJ-së³⁶;

- (iii) *Parimin e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i identifikuar dhe i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të analizuara.
- (iv) *Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit*. Në caktimin e masës së dënimit gjykata ka analizuar parimet kryesore të dënimit penal si një masë shtrënguese kundër personit fajtor që ka kryer veprë penale, *si parimin e ligjshmërisë, individualizimit të dënimit, të dobishmërisë së dënimit dhe të përshtatshmërisë së dënimit (proporcionalitetit)* sipas nenit 47 dhe 47/2 të K.Penal.
- (v) *Parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe parimin e disponibilitetit* në lidhje me të drejtën për tu njoftuar dhe dëgjuar si dhe në lidhje me kërkimet e palëve në vendimet civile.
- (vi) *Parimin e sigurisë juridike*³⁷, të nxjerrë gjatë analizës mbi qëllim dhe funksionin e institutit të parashkrimit fitues.
- (vii) *Parimin e Kodit Penal lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm për të pandehurin*, me qëllim përcaktimin e ligjit penal të zbatueshëm, duke analizuar dhe evidentuar dy ligjet (i) ligjin e kohës së kryerjes së veprës penale dhe (ii) ligjin e kohës së gjykimit të veprës penale, në respektim të nenit 3 të K.Penal.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Norma juridike analizohet në çdo komponent të saj, ku evidentohet zbërthimi sipas pjesëve përbërëse dhe lidhja e tyre me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qëllimit të normës dhe arsytimit pse ajo identifikohet si ligj i zbatueshëm mbi faktet konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

³⁶ Vendimi nr. 579 datë 26.06.2016 dhe vendimi nr. 1206 datë 20.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

³⁷ Vendimi nr. 1234 datë 23.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi mjaft të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare, të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtëshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirë organizuar dhe e standartizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithë përfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve, por në disa raste analiza teorike e fakteve dhe provave dhe ligjit është e tej zgjeruar, duke rritur volumin (shih dokumenti nr. 1 dhe dosja nr. 1). Gjyqtarja ka bërë praktikë të arsyetimit të vendimit edhe kompetencën, juridiksionin dhe përbërjen e trupit gjykues megjithëse të pakundërshtuar nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjykata. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, por në dy raste interpretimi i ligjit material (nenin 47 të K.Penal) që lidhet me masën e dënimit penal është i ulët (shih dosja nr. 2 dhe 4). Nga pikëpamja formale në 1 rast vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal është dhënë “Në emër të Republikës” kur kemi të bëjmë me kërkime të palëve në fazën e hetimeve paraprake. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor. Struktura e vendimeve të saj është e standartizuar. Ajo përmban në mënyrë të përgjithshme elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural civil e penal. Kështu, në pjesën hyrëse të dokumentit 1-3 dhe dosjet 1-5, janë shënuar gjeneralitetet e plota të palëve ndërgjyqse dhe, objekti dhe akuza e plotë dhe baza ligjore përkatëse. Pjesa arsyetuese hartohet me gjuhë të thjeshtë dhe me strukturë solide. Në dokumentat 1-3 dhe në dosjet 1-5, arsyetimi është strukturuar me nënpjesë të emëtuara me tituj, me paragrafët uniformë, por ka raste që paraqiten me tekst të gjatë dhe me citim të plotë të përmbajtjes së normave të ligjit të zbatueshëm dhe analizës së fakteve dhe provave, që rëndojnë qartësinë e tekstit (shih dokumenti nr. 1 dhe dosja nr. 1). Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, tregohet e drejta e ankimit për palët, duke përjashtuar 1 rast (shih dosja nr. 1). Dispozitivi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin përfundimtar. Subjekti i rivlerësimit i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat në asnjë rast nuk mungon shkaku ligjor (shih 5 dosjet e vëzhguara). Gjyqtarja ka disponuar edhe me vendime të ndërmjetme të ankimeshme për sigurimin e padisë shih dosja nr. 3) si dhe me lëshimin e urdhër ekzekutimit (shih dosja nr. 5)”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Gjyqtarja, përgjithësisht përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (gjithmonë konstatohet përdorimi i shkronjës “ç” dhe “ë”). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdoruara nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Përdor terma/shprehje në gjuhë të huaj në identifikimin dhe zbatimin kryesisht të të drejtave dhe parimeve³⁸ përgjithësisht të etiketuara në kllapa/thonjëza pas termit/shprehjes përkatëse të gjuhës shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë dhe i numërtuar, duke kaluar në mënyrë të qartë mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Mënyra e zgjedhjes dhe përdorimit të fjalëve siguron një balancim midis të shprehurit thjesht dhe konciz, me përdorimin e gjallë dhe të zhdërvjelltë të gjuhës shqipe.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Paragrafët përgjithësisht fillojnë me një fjali tematike, e cila përmbledh përmbajtjen e tij dhe shpreh idenë kryesore të mendimit të asaj njësie. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuara më parë, por siguron qëndrueshmëri të mendimit, pa ndërprerje të tij dhe e bën mendimin të rrjedhë natyrshëm, si një i tërë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

³⁸ Për shembull: “ratio legis”; “ipso jure”; “Judicis est judicare secundum et probata”; “ad excludendum”; “juria novit curia”; “ad substantiam”; “ad probationem”; “ipso legge”; “ex legge”; “ratione materia”; “ratione loci”; “ratione personae”; “ratione temporis”; “nullum crimen, nulla poena sine culpa”; “condicio sine qua non”; “causa pretendi”; “petitium”; “nulla poena sine lege”, “actus rea” etj.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi mjaft të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare, të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtëshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirë organizuar dhe e standartizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithë përfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve, por në disa raste analiza teorike e fakteve dhe provave dhe ligjit është e tej zgjeruar, duke rritur volumin (shih dokumenti nr. 1 dhe dosja nr. 1). Gjyqtarja ka bërë praktikë të arsyetimit të vendimit edhe kompetencën, juridiksionin dhe përbërjen e trupit gjykues megjithëse të pakundërshtuar nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjykata. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, por në dy raste interpretimi i ligjit material (nenin 47 të K.Penal) që lidhet me masën e dënimit penal është i ulët (shih dosja nr. 2 dhe 4). Nga pikëpamja formale në 1 rast vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal është dhënë “Në emër të Republikës” kur kemi të bëjmë me kërkime të palëve në fazën e hetimeve paraprake. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor. Struktura e vendimeve të saj është e standartizuar. Ajo përmban në mënyrë të përgjithshme elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural civil e penal. Kështu, në pjesën hyrëse të dokumentit 1-3 dhe dosjet 1-5, janë shënuar gjeneralitetet e plota të palëve ndërgjyqse dhe, objekti dhe akuza e plotë dhe baza ligjore përkatëse. Pjesa arsyetuese hartohet me gjuhë të thjeshtë dhe me strukturë solide. Në dokumentat 1-3 dhe në dosjet 1-5, arsyetimi është strukturuar me nënpjesë të emërtuara me tituj, me paragrafët uniformë, por ka raste që paraqiten me tekst të gjatë dhe me citim të plotë të përmbajtjes së normave të ligjit të zbatueshëm dhe analizës së fakteve dhe provave, që rëndojnë qartësinë e tekstit (shih dokumenti nr. 1 dhe dosja nr. 1). Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, tregohet e drejta e ankimit për palët, duke përjashtuar 1 rast (shih dosja nr. 1). Dispozitvi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin përfundimtar. Subjekti i rivlerësimit i kushton rëndësinë e*

duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat në asnjë rast nuk mungon shkaku ligjor (shih 5 dosjet e vëzhguara). Gjyqtarja ka disponuar edhe me vendime të ndërmjetme të ankimeshme për sigurimin e padisë shih dosja nr. 3) si dhe me lëshimin e urdhër ekzekutimit (shih dosja nr. 5).”

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet me argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumentave ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*), etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i tregon kujdes për prezantimin e fakteve, identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Evidentohet ndjekja e një metodologjie të qartë në strukturimin e pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Konkretisht në mënyrë më specifike konstatohet në çështjet penale se:

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënata e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti i shqyrtimit, akuza ndaj të pandehurit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkuese arsyetuese është e ndarë në disa pjesë në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) Rrethanat procedurale. Në këtë nënpjesë gjyqtarja ka renditur çështjet e kompetences dhe juridiksionit penal, për të vijuar më pas me kërkesat procedurale që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit të çështjes në themel, si pranimi ose jo i kërkesës për gjykim të shkurtuar apo mbi mënyrën e njoftimit të të pandehurit etj; (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes të integruara me provat (*në prezantimin e fakteve gjyqtarja bën një lidhje të provave me faktin penal të evidentuar*), pavarësisht mënyrës së procedimit të çështjes me gjykim të shkurtuar apo të zakonshëm; (iii) Në përgjithësi pasqyron edhe pretendimet e palëve gjatë gjykimit, pas parashtrimit të rrethanave të çështjes; (iv) Ligjin e zbatueshëm duke cituar dispozitat materiale dhe procedurale relevante në zgjidhjen e çështjes por njëkohësisht edhe jurisprudencën që gjen

zbatim në rastin konkret (*psh në lidhje me gjykimin e shkurtuar, bashkëpunimin etj*); (v) Vlerësimi dhe analiza juridike, në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me deklarimin e pafajshëm të të pandehurit apo dënimit të tij, masën e dënimit të të pandehurit, aplikimin e gjykimit të shkurtuar, mënyrën e vuajtjes së dënimit, shpenzimet gjyqësore dhe hetimore, e drejta e ankimit si dhe vendi dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se në çështjet e kategorisë “krime”, vendimet përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383/ç të K.Pr.Penale të ndryshuar, dhe në vendimet kërkesa penale me objekt caktim mase sigurimi kriteret e parashikuara në nenin 245 të K.Pr.Penale.

Në çështjet civile në mënyrë më specifike konstatohet se :

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit ligjore të tyre, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkuese arësyetuese është e ndarë në disa pjesë të listuara përgjithësisht si “Procedura”, “Rrethanat e faktit”, “Legjislacioni i zbatueshëm” apo “Analiza juridike”, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) Në këtë nënpjesë gjyqtarja ka renditur çështjet e kompetences dhe juridiksionit civil, për të vijuar më pas me kërkesat procedurale që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit të çështjes në themel, si pranimi ose jo i kërkesës për sigurimin e padisë, kërkesa për kalimin procedural, etj; (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim; (iii) Pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iv) Ligjin e zbatueshëm dhe (v) Vlerësimi i gjykatës në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë, shpenzimet gjyqësore e drejta e ankimit si dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile.

Në tërësi nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, gjithmonë sipas këtij rendi : trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura ose jo gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, (*në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese e cila mos pasqyrimin e pretendimeve të palëve e ka vlerësuar si cënim të të drejtës për akses në gjykatë dhe të drejtës për t’u dëgjuar*), ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata (*kryesisht konstatohet tek vendimi nr. 378 datë 29.07.2014 dhe vendimi nr. 1234 datë 23.12.2014 dhe vendimet me objekt dëmshpërblim që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës, shtrimi i çështjeve për zgjidhje sipas metodës IRAC*) duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese, përfundimet e arritura nga gjykata. Në tërësi konstatohet që pjesët përbërëse të

cituarë më sipër, të jenë vendosur me titujt përkatës në pjesën arsyetuese të vendimit, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta për përmbajtjen e vendimit. Gjyqtarja ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, sipas pjesëve të vendimit, ku gjyqtarja zbaton rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve proceduriale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.³⁹

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

³⁹ Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi mjaft të mira në arsyetimin ligjor. Përmbajtja e vendimit është gjithë përfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve, por në disa raste analiza teorike e fakteve dhe provave dhe ligjit është e tej zgjeruar, duke rritur volumin (shih dokumenti nr. 1 dhe dosja nr. 1). Gjyqtarja ka bërë praktikë të arsyetimit të vendimit edhe kompetencën, juridiksionin dhe përbërjen e trupit gjykues megjithëse të pakundërshtuar nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjykata. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, por në dy raste interpretimi i ligjit material (nenin 47 të K.Penal) që lidhet me masën e dënimit penal është i ulët (shih dosja nr. 2 dhe 4).....”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuar rezultojnë një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore (si psh; në lidhje me gjendjen e flagrancës, ekzistenca e dyshimit të arësyeshëm, pavlefshmërisë së titujve ekzekutiv, pavlefshmërisë së titujve ekzekutiv, nëse kontrata e punës së paditësit ka qënë me apo pa afat, nëse mënyra e përfundimit të marrëdhënies së punës ka qënë normale apo e jashtëzakonshme, etj) në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në të gjitha vendimet gjyqësore edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të shprehur, ngritja e çështjes apo pyetjes ligjore në mënyrë eksplicite, vjen e nënkuptuar nga analiza dhe arritja e përfundimit ligjor. Konstatohet identifikimi i tekstit normativ (civil apo penal) për t’u aplikuar, identifikimi i faktit se si teksti do të interpretohet, duke aplikuar faktet nga të dhënat në normë dhe pastaj konkluzionet.

Gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezultojnë e nevojshme dhe qëllimit të parashikimit të tyre psh: (i) *Instituti të pavlefshmërisë së titujve ekzekutiv dhe pasojave që rrjedhin prej saj;* (ii) *Instituti të parashkrimit fitues, i lidhur me nevojën për krijimin e qëndrueshmërisë dhe të sigurisë në qarkullimin juridik të të mirave të pasurive të paluajtshme dhe të drejtave të krijuara mbi sendet e paluajtshme;* (iii) *Instituti të zgjidhjes së marrëdhënies së punës, shkaqet që të çojnë në zgjidhjen e saj si dhe zgjidhjen e pasojave ligjore që rrjedhin prej saj;* (iv) *instituti të pushimit individual nga puna në mënyrë të jashtëzakonshme, duke e konsideruar si një formë e përfundimit të marrëdhënies së punësimit që kryhet nga ana e punëdhënësit në mënyrë të njëanshme dhe për shkaqe të punëmarrësit, qëllimit të këtij instituti në funksion të dhënies së argumenteve ligjore nëse ky qëllim është përmbushur në rastin objekt gjykimi;* (v) *Instituti të martesës dhe shkaqet që të çojnë në zgjidhjen e saj si dhe zgjidhjen e pasojave ligjore që rrjedhin prej saj;* (vi) *Instituti të bashkëpunimit, për të përcaktuar nëse vepra penale atribuar të pandehurve është kryer në bashkëpunim;* (vii) *Instituti*

të dënimit apo edhe të alternativave të dënimit duke përcaktuar qëllimin, funksionin e tyre si dhe kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për zbatimin e tyre, duke i analizuar në mënyrë të detajuar këto kriteret në ligj në përputhje me provat dhe rrethanat në çdo rast gjykimi;

Në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur për arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak – pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore midis veprimeve/mosveprimeve dhe pasojës, në çështjet penale.

Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse si në çështjet civile ashtu edhe në çështjet penale. Në vendimet e analizuara, pretendimet e palëve janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, në të cilën paraqiten në mënyrë të hollësishme herë në nënndarje të veçantë dhe herë pas rrethanave të çështjes. Analiza e këtyre pretendimeve, me natyrë procedurale, në lidhje me provueshmërinë apo kualifikimin ligjor të faktit penal, apo me bazueshmërinë e çështjes në themel, bëhet në pjesën e arsyetimit ligjor të vendimit, duke u pozicionuar dhe analizuar në pjesën e duhur të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke marrë gjithmonë përgjigje të argumentuar në drejtim të mbështetjes në ligj ose prova të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Gjyqtarja analizon konceptet ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes mbi bazën e një zhvillimi dhe argumenti logjik. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 04.11.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Lidhur me efektivitetin në punë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, është subjekt ndaj të cilës zbatohet vendimi i ish-KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi Vlerësimit të Gjyqtarëve, Aneksi 1, “Për kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Rrjedhimisht, analiza e të dhënave të saj bëhet në referencë të këtij vendimi dhe të ligjit procedural për çështje të veçanta. Për aspektin sasior sipas pikës 3, gërma “g” të vendimit të ish KLD-së, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë që nuk është i organizuar me skesione, si relator gjykon jo më pak se 200 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me krime e kv/penale dhe civile me mosmarrëveshje me palë kundërshtare. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar 1.270 çështje dhe ka përfunduar 1.193 çështje, duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 80 çështje. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar 1.042 çështje nga të cilat 188 penale themeli, 82 kërkesa penale dhe 24 masa sigurimi, 274 civile themeli dhe 126 familjare, 128 civile të veçanta, 59 urdhër mbrojtje dhe 128 urdhër ekzekutimi, ose 588 çështje sipas standartit. Për aspektin sasior pikës 3, gërma “g” të vendimit të ish KLD-së, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë që nuk është i organizuar me skesione, si relator gjykon jo më pak se 200 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me krime e kv/penale dhe civile me mosmarrëveshje me palë kundërshtare. Rrjedhimisht bazuar në të dhënat e mësipërme mesatarja e gjykimit për subjektin {...} është 196 çështje penale e civile në vit, ose nën standartin minimal të caktuar me vendim të KLD-së. Për aspektin kohor sipas pikës 5 gërma “a”*

,”d” dhe dhe “e” të vendimit të ish KLD-së, në gjykatën e shkallës parë, krimet gjykohen për 9 muaj, kv/penale për 4 muaj, civile familjare për 4 muaj dhe civile të përgjithshme për 6 muaj. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë në intervale kohore nga 3 ditë (shih dosjen nr. 1), deri në 5 muaj e 19 ditë (shih dosjen nr. 5). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 8 ditë (shih dosjen nr. 4), 3 muaj e 12 ditë (shih dosjen nr. 3) dhe 2 muaj (shih dosjen nr. 2). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, prej 5 muaj e 19 ditë, e cila del edhe tej afatit 4 mujor të gjykimit (shih dosjen nr. 5), ka qenë çështje civile familjare dhe në përfundim është disponuar me vendim themeli, por 3 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të gjëndjes shëndetësore të gjyqtarës dhe mungesës së palës paditur. Ndërsa në 3 dokumentet ligjore të prezantuara nga vetë gjyqtarja rezultoi se afati i gjykimit ka qenë 4 muaj e 24 ditë (shih dokumenti nr. 1), 8 muaj (shih dokumenti nr. 2) dhe 5 muaj e 8 ditë (shih dokumenti nr. 3). Nga këto vetëm në 1 rast është tejkaluar me 2 muaj, afati 6 mujor i gjykimit (shih dokumenti nr. 2). Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultoi se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “08 tetor 2013-08 tetor 2016”, për gjyqtarën {...} janë paraqitur 3 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (2 në vitin 2015 dhe 1 ankesë në vitin 2016) nga të cilat 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për zvarritje gjykimi dhe i është regjistruar gjyqtarës për efekt të vlerësimit profesional dhe etik dhe « tërheqje vëmendje me shkrim.»

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezultoi se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe një vendimi të administruar për shkak referimi nga ish/Inspektorati i KLD-së për tu mbajtur parasysht për efekt të vlerësimit etik dhe profesional.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu edhe për çështjet civile, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor në Kodin e Procedurës Civile për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezultoi se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit.

Konkretisht: Çështja e kategorisë «kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake» (*caktim mase sigurimi*), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin, afati 5 ditë nga momenti i rregjistrimit të kërkesës në gjykate. Referuar vendimit nr. 19 datë 23.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat rezultoi se kërkesa për caktimin e masës ka si datë rregjistrimi datën 19.06.2014 dhe datë vendimi datën 23.06.2014. Rezultoi që është respektuar afati 5 ditë i parashikuar në nenin 244 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe se edhe kjo çështje rezulton që të jetë përfunduar brenda afatit ligjor për përfundimin e saj, rezulton se raporti i shprehur në përqindje është 0 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet 15 pikë pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej afatit ligjor, është 0%.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se nga ana e gjyqtarës janë respektuar standardet minimale kohore të gjykimit, duke iu referuar të njëjtit konkluzion të cituar në treguesin më sipër, për shkak se analiza e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet me afati ligjor dhe standard minimal kohor është bërë së bashku në raport.⁴⁰

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

⁴⁰Shih konkluzionin e Raportit të KLGJ-së, cituar në treguesin më sipër.

Për të gjitha çështjet: (i) 10 (dhjetë) çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi dhe (ii) 3 (tre) vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, gjykimi në përgjithsi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së⁴¹.

Referuar 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja, konstatohet se:

- (i) Vendimi penal nr. 378 datë 29.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me kërkues Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat ndaj të pandehurve I.Pepa dhe A.Metushi të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 135 - 25 të K.Penal. Referuar të dhënave të vendimit rezultojnë se çështja mban si datë rregjistrimi 05.03.2014 dhe datë përfundimi 29.07.2014, pra rezultojnë që çështja ka përfunduar brenda një afati prej 4 (katër) muaj dhe 24 (njëzet e katër) ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD edhe pse çështja është zhvilluar me ritin e gjykimit të zakonshëm.
- (ii) Vendimi civil nr. 1234 datë 23.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës A.Pano, kundër të paditurit T.Kosova, me objekt të padisë: “ Njohje pronësie me parashkrim fitues.” Referuar të dhënave të vendimit rezultojnë se çështja mban si datë rregjistrimi 24.04.2014 dhe datë përfundimi 23.12.2014 pra rezultojnë që çështja ka përfunduar brenda një afati prej 8 (tetë) muajsh, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD⁴².
- (iii) Vendimi civil nr. 792 datë 29.07.2014. i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Xh.Mishova, kundër të paditurit Cez Shpërndarje sha, me objekt të padisë: «Dëshpërblim që rrjedh nga marrëdhëniet e punës”. Referuar të dhënave të vendimit rezultojnë se çështja mban si datë rregjistrimi 21.02.2014 dhe datë përfundimi 29.07.2014 pra rezultojnë që çështja ka përfunduar brenda një afati prej 5 (pesë) muaj dhe 8 (tetë) ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.

Referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short,⁴³ konstatohet se:

- (i) Çështja penale nr. 465 regj them, datë 25.07.2014 regjistrimi, që i përket kërkuesit; Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat ndaj të pandehurit L.Hoxha., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtimit mjeteve në mënyrë të parregullt» e përfunduar me vendimin nr. 471 datë 30.10.2014. Sipas të dhënave rezultojnë se data e rregjistrimit është 25.07.2014 dhe data e përfundimit të çështjes data 30.10.2014. Pra referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 3 (tre) muaj dhe 5 (pesë) ditë, brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

⁴¹ Sipas vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjyqimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.” Gjykimet civile në Gjykatën e Shkallës së parë jo më tej se 6 muaj dhe 4 muaj gjykimet familjare me palë kundërshtarë”

⁴² Në llogaritjen e afatit është përfshirë edhe periudha e pushimeve vjetore në muajin Gusht.

⁴³ Sikundër kemi analizuar nga 11 çështje të përzgjedhura me short, 1 prej tyre parashikon afat ligjor dhe 10 afat standard minimal kohor për përfundimin e tyre.

- (ii) Në çështjen penale nr. 332 rregj dt rregj 17.05.2016 ndaj të pandehurit K.Sheti akuzuar për kryerjen e veprës penale të “ *Drejtimit mjeteve në mënyrë të parregullt*” parashikuar nga neni 291 i K.Penal sipas të dhënave rezulton se data e rregjistrimit është 17.05.2016 dhe data e përfundimit të çështjes 26.05.2016. Çështja ka përfunduar për 9 (nëntë) ditë, pra brenda afatit standard minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD duke u nisur nga data e rregjistrimit të çështjes.
- (iii) Në çështjen penale nr. 490 rregj datë 09.09.2014 që i përket të pandehurit N.Demaj akuzuar për veprën penale të «*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive*» parashikuar nga neni 280 i K.Penal sipas të dhënave, rezulton se data e rregjistrimit është 09.09.2014 dhe data e përfundimit të çështjes 27.10.2014. Çështja ka përfunduar për një afat prej 1 (një) muaj dhe 18 (tetëmbëdhjetë) ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 4 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e rregjistrimit të çështjes (për kundravajtjet penale).
- (iv) Në çështjen penale nr. 717/103 rregj datë rregj 24.12.2015 ndaj të pandehurit A.Mollaj akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Ndërtimit të paligjshëm*” parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, sipas të dhënave rezulton se data e rregjistrimit është 24.12.2015 dhe data e përfundimit të çështjes 03.03.2016, pra çështja ka përfunduar për një afat kohor prej 2 (dy) muaj dhe 9 (nëntë) ditë, pra brenda afatit standard minimal kohor prej 4 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, (për kundravajtjet penale).
- (v) Çështja civile nr. 830 regj them, datë 31.03.2015 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës P.M kundër palës së paditurit OSHEE sha, me objekt të padisë “*Konstatim pavlefshmërie absolute të titullit ekzekutiv*”, e përfunduar me vendimin nr. 810 datë 13.07.2015. Pra referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 3 (tre) muaj dhe 13 (trembëdhjetë) ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.
- (vi) Çështja civile nr. 759 regj them, datë 16.03.2015 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Albtelekom sha, me objekt të padisë “*Përmbushje detyrimi kontraktor*”, e përfunduar me vendimin nr. 666 datë 10.06.2015. Pra referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 2 (dy) muaj dhe 24 (njëzet e katër) ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.
- (vii) Në çështjen civile nr. 931 rregj datë rregjistrimi 15.04.2016 me objekt të padisë «*Dëmshpërblim nga zgjidhja e kontratës së punës*», përfunduar me vendimin nr. 849 datë 18.07.2016. Referuar të dhënave rezulton se çështja ka përfunduar në një afat prej 3 (tre) muaj dhe 3 (tre) ditë, pra brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (viii) Në çështjen civile nr. 813 rregj datë rregjistrimi 05.05.2014 me objekt të padisë «*Dëmshpërblim nga zgjidhja e kontratës së punës*», përfunduar me vendimin nr. 731 datë 17.07.2014. Referuar të dhënave rezulton se çështja ka përfunduar në një afat prej 2 (dy) muaj dhe 12 (dymbëdhjetë) ditë, pra brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (ix) Në çështjen familjare nr. 1737/354 rregj datë 02.12.2015 me palë paditëse A.K kundër Xh.K me objekt të padisë «*Zgjidhje martesë*», përfunduar me vendimin nr. 579 datë 26.06.2016. Pra referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 6 (gjashtë) muaj dhe 24 (njëzet e katër) ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 4 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

(x) Në çështjen familjare nr. 1293 rregj datë 10.08.2015 me palë paditëse F.E vs Z.E me objekt të padisë «Zgjidhje martesë», përfunduar me vendimin nr. 1206 datë 20.11.2015. Pra referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 3 (tre) muaj dhe 10 (dhjetë) ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së. Nëse nga ky afat nuk do të llogaritim 20 ditë pushim të muajit gusht, periudhë kjo e cila përkon me pushimet vjetore të gjyqtareve, afati i përfundimit të gjykimit të çështjes do të ishte 2 (dy) muaj dhe 20 (njëzet) ditë.

- Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “08 tetor 2013 - 08 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 3 (tre) ankesa në Inspektoratin e KLD-së (2 në vitin 2015 dhe 1 ankesë në vitin 2016) nga të cilat 1 (një) ankesë e vitit 2015 verifikuar për zvarritje gjykimi i është regjistruar gjyqtares për efekt të vlerësimit profesional dhe etik dhe “tërheqje vëmendje me shkrim”.

Referuar të dhënave në lidhje me praktikën e trajtimit të ankesave si më sipër rezulton se:

(i) Në datë 12.09.2015 me nr. 2948 prot është paraqitur një ankesë për zvarritje të gjykimit nga ankuesi Q. Koxhaj. Në datë 01.10.2015 me nr. 3086 prot është paraqitur përsëri një ankesë po nga ky shtetas për të njëjtën çështje dhe për të njëjtin shkak (zvarritje të gjykimit). Nga ana e ish KLD-së është bërë bashkimi i kësaj ankesë të dytë të përsëritur me ankesën e parë nr. 2948 prot datë 12.09.2015.

(ii) Ankesa nr. 2098 prot datë 26.05.2016 për verifikim për mosrespektim formal të ligjit i është përcjellë ILD-së e regjistruar pranë ILD me nr. 2815 prot datë 23.11.2020 e cila me vendimin nr. 4211/1 prot datë 25.11.2021 ka vendosur: “Arkivimin e ankesës së av. A.B dhoma e avokatisë Tiranë”.

(i) Në lidhje me ankesën nr. 2948 prot bashkuar me ankesën nr. 3086 prot, nga relatiimi datë 09.12.2015 mbi verifikimin e ankesës rezulton se: Ankuesi Q.Koxhaj ankohet për veprimtarinë gjyqësore të gjyqtares lidhur me zvarritjen e gjykimit të çështjes civile nr. 499/47 datë rregj 17.02.2014 me palë paditëse E.Cufe, palë e apditur K.Baze me objekt të padisë “Lirim dhe dorëzim sendi”. Pas verifikimit të ankesës nga ana e Inspektorëve të KLD-së rezultoi se: Çështja civile ka përfunduar për një afat prej 1 vit 8 muaj dhe 8 ditë nga ana e gjyqtares {...}. Po kështu rezulton që janë zhvilluar gjithsej 25 seanca nga të cilat 1 seancë përgatitore dhe 24 seanca gjyqësore. Sipas këtij relacioni rezulton se jo të gjitha shkaqet e shtyrjeve të seancave kanë qënë për arsye procedurale dhe në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor pasi 2 seanca janë shtyrë për shkak se gjykata ka vendosur të therrasë persona të tretë, 2 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak së ekspertja duhet të parapaguhet, 3 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së gjykatës, një rast feste, një rast seminar dhe një rast vdekjeje, 3 seanca janë shtyrë për shkak se gjyqtarja ka kërkuar informacion pranë institucioneve shtetërore si ZVRPP Skrapar dhe ZGJC Poliçan, dhe një seancë pasi gjyqtarja ka vendosur që të kryejë riekspertim. Nga ana e inspektorëve është konkluduar se në rastin konkret çështja ka përfunduar tej afatit standard të përcaktuar (6 muaj sipas vendimit 261/2010 të KLD-së) dhe se çështja duhej të ishte menaxhuar më mirë nga ana e gjyqtares duke shmangur shumë nga seancat joproductive. Konkretisht gjyqtarja duhej të kishte menaxhuar më mirë çështjen duke i lënë seancat më afër njëra-tjetrës,

me qëllim që gjykimi të përfundonte brenda afateve, të merrte masa për njoftimin në kohë të të gjithë personave që janë palë e paditur apo persona të tretë, nuk është menaxhuar mirë rasti pasi nga ana e gjykatës janë bërë 2 akte ekspertimi. Po kështu referuar objektit të padisë duhet të kishte vepruar më me dilijencë për të kërkuar që në fillim nga institucionet e treta dokumnacionin e nevojshëm për një zhvillim të plotë dhe të gjithanshëm.

Nga ana e KLD-së në përfundim është vendosur: *Tërheqje vëmendje për Gjyqtaren {...} lidhur me ankesën nr. 2984 prot datë 17.09.2015 për zvarritje gjykimi pasi afati i gjykimit është tejkaluar me 1 vit dhe 2 muaj.*

Në fakt, referuar të dhënave të çështjes të referuar në vendimin e KLD-së rezulton se çështja nuk ka përfunduar për një periudhë prej 1 vit 8 muaj dhe 8 ditë nga ana e gjyqtarës {...} kjo pasi edhe pse çështja mban si datë rregjistrimi datën 17.02.2014, vetëm në datë 17.04.2014 i ka kaluar me short për gjykim gjyqtarës {...} pasi më parë ka qënë për shqyrtim tek një tjetër gjyqtare. Pra duke qënë se gjyqtarja {...} e ka marrë çështjen në datë 17.04.2014 që nga kjo datë duhet të ecin afatet për vlerësimin e saj. Çështja ka përfunduar me vendimin e datës 27.10.2015 pra, pas 1 vit dhe 6 muaj nga momenti i caktimit me short. Gjithashtu në ecjen e afatit të gjykimit të çështjes nuk duhet të përllogaritet edhe periudha e pushimeve vjetore (*në muajin Gusht 2014 dhe muajin Gusht 2015*) të cilat e rrisin edhe me 2 muaj përfundimin e gjykimit të çështjes. Në këtë kontekst, nëse do të zbresim edhe këto dy muaj do të rezultonte që çështja është përfunduar nga ana e gjyqtarës {...} për një kohë prej 1 (një) vit, 4 (katër) muaj dhe 10 (dhjetë) ditë nga momenti i marrjes së kësaj çështje në short.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 14 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore (*duke përfshirë këtu edhe vendimin që i është verifikuar për zvarritje gjykimi nga KLD*), sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së pasi 3 (tre) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të përcaktuar për secilën kategori. Pra në total 21.4 % të çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar vetëm për 79 % të çështjeve të analizuar. Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 21.4 % përkon me nivelin e vlerësimit 3 (tre) pikë. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në kontekst të sa më sipër arsyetohet, u analizua kompleksiteti i çështjeve i përcaktuar në Metodologji si një nga komponentët që mund të çojë në një pikëzim më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore nga e cila rezultoi se:

1. Çështja që i përket vendimit civil nr. 1234 datë 23.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me objekt të padisë: “Njohje pronësie me parashkrim fitues.” Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë rregjistrimi 24.04.2014 dhe datë përfundimi 23.12.2014 pra rezulton që çështja ka përfunduar brenda një afati prej 8 (tetë) muajsh, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.

Afati i tejkalimit të çështjes nga standardi minimal kohor është 2 muaj, por këtu duhet të mbahet në vëmendje edhe fakti se muaji Gusht (30 ditë) përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve e në këtë kontekst nuk duhet të përlogaritet në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar vetëm me 30 ditë tej standardit. Në dosje nuk ka të dhëna në lidhje me shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore apo me mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes, pasi ky vendim është vendim i përzgjedhur nga ana e gjyqtarës, por referuar të dhënave procedurale të cituara në arsyetimin e vendimit rezulton se gjatë gjykimit nga ana e gjykatës është bërë kalimi procedural i një prej palëve të paditura konform nenit 199 të K.Pr.Civile (pas paraqitjes së dëshmisë së trashëgimisë nga pala ndërgjyqëse) si dhe rezulton që të jetë kryer akti i ekspertimit teknik me qëllim dhënien zgjidhje çështjeve teknike për zgjidhjen sa me drejtë të mosmarrëveshjes. Kjo ecuri procedurale dhe kjo shkallë kompleksiteti duhet të mbahet parasysht nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimit e gjyqtarës.

2. Çështja familjare nr. 1737/354 rregj datë 02.12.2015 me palë paditëse A.K vs Xh.K me objekt të padisë « Zgjidhje martese », përfunduar me vendimin nr. 579 datë 26.06.2016. Pra referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 6 (gjashtë) muaj dhe 24 (njëzet e katër) ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 4 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së, me 2 muaj dhe 24 ditë tej afatit standard minimal kohor. Nga të dhënat e dosjes rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë më 02.12.2015 dhe me shortin e datës 07.12.2015, ajo i është caktuar gjyqtarës {...}. Me vendim të datës 22.12.2015 (pas 15 ditëve) gjyqtarja ka vendosur caktimin e seancës përgatitore të pajtimit në datën 04.02.2016, ora 13.30. Data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10 ditor të përcaktuar nga neni 155 i K.Pr.Civile. Seanca përgatitore datë 04.02.2016, ora 13.30, nuk është zhvilluar pasi gjyqtarja nuk është paraqitur për shkaqe shëndetësore (raport mjekësor). Seanca përgatitore e datës 01.03.2016, ora 09.00, është shtyrë pasi, gjykata bazuar në nenin 135 të K.Familjes ka përsëritur edhe një herë thirrjen për të paditurin. Seanca gjyqësore e datës 14.04.2016, ora 11.00 nuk është zhvilluar pasi përsëri gjyqtarja nuk është paraqitur në punë për shkaqe shëndetësore. Pra nga të dhënat rezulton se dy seanca nuk kanë qënë efektive pasi nuk janë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarës për shkaqe shëndetësore, ndërkohë që një seancë përgatitore ka qënë efektive pasi konform nenit 134 dhe 135 i K.Familjes i padituri që nuk paraqitet në gjykim megjithë dijeninë e rregullt duhet të njoftohet dy herë nga ana e gjykatës. Rezulton gjithashtu që seancat gjyqësore janë lënë në afate të afërta me njëra - tjetrën nga 13 ditë deri në 1 muaj. Pra referuar faktit që nëse dy seancat që janë shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarës për shkaqe shëndetësore (shkak i ligjshëm) do të kishin rezultuar produktive, atëherë çështja mund të ishte përfunduar brenda afatit 4 muajor të përcaktuar në vendim, çka duhet të mbahet parasysht nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimit e gjyqtarës. .

3. Ndërkohë në lidhje me çështjen e trajtuar me vendim datë 09.12.2015 nga ana e KLD-së për të cilën është vendosur “Tërheqje vëmendje” për zvarritje të gjykimit, kjo çështje nuk mund të konsiderohet në afat pasi pavarësisht faktit se në përgjithsi shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore kanë qënë në funksion të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, tejkalimi i afatit me 8 muaj nuk e justifikon atë⁴⁴.

⁴⁴ Këtu është zbritur edhe periudha prej dy muaj (për vitin 2014 dhe 2015) të pushimeve vjetore të gjykatës në muajin Gusht, në këtë kontekst rezulton që çështja të jetë përfunduar për një kohë prej 1 vit, 4 muaj dhe 10 ditë nga ana e Gjyqtarës.

Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar në total për 3/vite periudhë vlerësimi 1042 çështje, nga të cilat 649 çështje themeli në tre vite, mesatarisht 216 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 200 çështje në vit, duke tejkalluar këtë standard me 16 çështje në vit, ngarkesë pune që nuk justifikon pikëzim maksimal të gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuar si më sipër cituar, që rezulton në masën 21.4 %;
- (ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit (*mungesa e gjyqtarës për shkaqe shëndetësore vlerësohet shkak i ligjshëm dhe jo përgjegjesi e gjyqtarit*);
- (iii) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm mesatarisht me 16 çështje në vit;

vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga të dhënat statistikore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 4 pikë, pasi shqyrtimi i 21 % të çështjeve jashtë standardit minimal, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Nga ana tjetër analiza logjike e të dhënave të burimeve të vlerësimit nuk justifikon pikëzim maksimal për këtë tregues, sepse tejkalimi i treguesit minimal sasior është i papërfillshëm dhe kompleksiteti i çështjes jo gjithmonë ka qenë përcaktues në kohëzgjatjen e gjykimeve.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin e analizimit të aftësive profesional të KLGJ-së nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat e Shkallës së Parë në periudhën e vlerësimit.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit, si dhe 1 dosje të referuar nga ish KLD si më sipër cituar.⁴⁵

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori, rezultojnë se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështjet në kategorinë e çështjeve “penale krimet”, rezultojnë të jetë 83 ditë ose 2 muaj dhe 23 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj për gjykimin e çështjeve penale të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “kundravajtje penale”, rezultojnë të jetë 58 ditë ose afërsisht 2 muaj, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 muaj për gjykimin e çështjeve kundravajtje penale në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 7 (shtatë) çështjet në kategorinë e çështjeve “civile themeli”⁴⁶, rezultojnë të jetë rreth 173.5 ditë, ose 5 muaj dhe 23 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (iv) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “familjare me palë kundërshtare”, rezultojnë të jetë 4 (katër) muaj dhe 22 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 4 (katër) muajsh për gjykimin e çështjeve familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë.

KONKLUZIONI

Referuar analizës matematikore si më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 4 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, tejkalohet vetëm për një kategori (*familjare me palë kundërshtare*), me 22 ditë si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja lidhur me gjykimin e kësaj kategorie çështjesh, vlerësohet se ky tregues duhet të pikëzohet maksimalisht me 5 pikë.

⁴⁵ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.”.

⁴⁶ Duke përfshirë këtu përveç çështjeve civile burim vlerësimi të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe ato me short edhe vendimin civil date 27.10.2015 për të cilën ka marrë edhe vërejtje për zvarritje të gjykimit si më sipër cituar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ -së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti rivlerësimi {...} në periudhën e rivlerësimi 04.11.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Lidhur me efektivitetin në punë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, është subjekt ndaj të cilës zbatohet vendimi i ish-KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi Vlerësimi të Gjyqtarëve, Aneksi 1, “Për kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Rrjedhimisht, analiza e të dhënave të saj bëhet në referencë të këtij vendimi dhe të ligjit procedural për çështje të veçanta. Për aspektin sasior sipas pikës 3, gërma “g” të vendimit të ish KLD-së, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë që nuk është i organizuar me skesione, si relator gjykon jo më pak se 200 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me krime e kv/penale dhe civile me mosmarrëveshje me palë kundërshtare. Subjekti i rivlerësimi ka deklaruar se për tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar 1.270 çështje dhe ka përfunduar 1.193 çështje, duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 80 çështje. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimi 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar 1.042 çështje nga të cilat 188 penale themeli, 82 kërkesa penale dhe 24 masa sigurimi, 274 civile themeli dhe 126 familjare, 128 civile të veçanta, 59 urdhër mbrojtje dhe 128 urdhër ekzekutimi, ose 588 çështje sipas standartit. Për aspektin sasior pikës 3, gërma “g” të vendimit të ish KLD-së, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë që nuk është i organizuar me skesione, si relator gjykon jo më pak se 200 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me krime e kv/penale dhe civile me mosmarrëveshje me palë kundërshtare. Rrjedhimisht bazuar në të dhënat e mësipërme mesatarja e gjykimit për subjektin {...} është 196 çështje penale e civile në vit, ose nën standartin minimal të caktuar me vendim të KLD-së.”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhje, konstatohet se për periudhën e rivlerësimi 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar 1.042 çështje nga të cilat 188 penale themeli, 82 kërkesa penale dhe 152 masa sigurimi (128 vleftësim/caktim +24 caktime), 274 civile themeli, 2 çështje tregtare dhe 126 familjare, 31 civile të veçanta, 59 urdhër mbrojtje dhe 128 urdhër ekzekutimi, ose 649 çështje me palë kundërshtare sipas standartit. Por sipas dosjes së

rivlerësimit, gjyqtarja ka filluar të ushtrojë detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat në muajin janar 2014. Kështu që të dhënat statistikore si më sipër i përkasin periudhës janar 2014-08.10.2016 (2 vjet e 9/muaj).

Referuar tabelave statistikore për periudhën janar 2014 - 08.10.2016 rezultojnë të dhënat e mëposhtme për kategori çështjesh për çdo vit kalendarik :

- (i) Viti 2014 : Gjithsej 197 çështje themeli- në standardin e miratuar;
- (ii) Viti 2015 : Gjithsej 295 çështje themeli, -afërsisht 50% më shumë se standardi i miratuar;
- (iii) Viti 2016 (9/muaj) : Gjithsej 157 çështje themeli, në standardin e miratuar duke llogaritur periudhën 9/mujore.

Për aspektin sasior sipas pikës 3, gërma “g” të vendimit të ish KLD-së, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë që nuk është i organizuar me seksione, si relator gjykon brenda një viti kalendarik jo më pak se 200 çështje që kanë të bëjnë me krime e kv/penale dhe civile me mosmarrëveshje me palë kundërshtare, i llogaritur në periudhë 3/vjeçare jo më pak se 600 çështje themeli.

Referuar të dhënave në vërtetimin Nr. 26 Prot, datë 09.01.2017, lëshuar nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, bashkëlidhur Formularit të Vetëdeklarimit, shënohen të dhënat statistikore të ndara sipas viteve kalendarike dhe konkretisht:

- Në vitin 2014, i janë caktuar 406 çështje, ka përfunduar 322 çështje.
- Në vitin 2015, i janë caktuar 458 çështje, ka përfunduar 460 çështje.
- Në vitin 2016, i janë caktuar 408 çështje, ka përfunduar 411 çështje.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së 08.10.2013-08.20.2016 si dhe për kategoritë e çështjeve të gjykuara respektivisht brenda të njëjtit vit kalendarik, dhe po kështu nuk është përlllogaritur rendimenti sipas të dhënave statistikore nga raporti i vlerësimit të KLGJ-së, duke u bazuar në të dhënat statistikore të Kryetarit të Gjykatës për të gjithë periudhën 3/vjeçare 01.01.2014-31.12.2016, e cila në këtë rast konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi, rendimenti duhet të përcaktohet referuar raportit të çështjeve të përfunduara 1193 çështje me çështjet e caktuara 1272 çështje gjatë periudhës së vlerësimit, në masën 94%.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 94 %. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8/pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”* Bazuar në këtë parashikim dhe në analizën statistikore si më sipër, rezulton se gjyqtarja vetëm për 1/vit ka

tejkalim te standardit minimal të ngarkesës, ndërkohë që për dy vitet e tjera ky standard nuk tejkalohe, fakt që vjen në përputhje edhe me konkluzionet e raportit analitik te vlerësimit të aftësive të saj profesionale, prandaj nuk justifikohet një shkallë me e lartë pikëzimi. Në të njëjtin konkluzion arrihet edhe nëse tejkalimi i standardit minimal sasior do të llogaritej për një periudhë 3/vjeçare, pasi referuar të dhënave statistikore ka rezultuar se gjyqtarja ka një mesatare gjykimi prej 216 çështje/vit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja pikëzohet me 8 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: “Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, sipas afatit 5 dhe 10 ditor të përcaktuar nga nenet 113 të K.Pr.Penale dhe 308 të K.Pr.Civile, nga vëzhgimet e 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se arsyetimi i vendimeve është kryer në interval kohor nga 1 ditë (shih dosja nr. 1) deri në 25 ditë (afati më i gjatë- dosja nr. 5). Në rastet e tjera afati i dorëzimit është 5 ditë (shih dosja nr. 2), 8 ditë (shih dosja nr. 3), 6 ditë (shih dosja nr. 4). Ndër 5 dosjet e vëzhguara 2 vendime janë arsyetuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në ligjin e posaçëm procedural civil dhe penal (shih dosjet nr. 4 dhe 5), ndërsa tre vendime brenda afatit ligjor (shih dosjet nr. 1, 2 dhe 3)”.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10/ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit vlerësohet të merret data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive.

Sa më sipër, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- (i) Çështja civile nr. 759 regj them, datë 16.03.2015 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Albtelekom sha, me objekt të padisë “*Përmbushje detyrimi kontraktor*”, e përfunduar me vendimin nr. 666 datë 10.06.2015. Referuar shenimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 25.06.2014, pra 9 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (ii) Në çështjen civile nr. 813 rregj datë rregjistrimi 05.05.2014 me objekt të padisë «*Dëmshpërblim nga zgjidhja e kontratës së punës*», përfunduar me vendimin nr. 731 datë 17.07.2014. Referuar shenimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 21.07.2014, pra 4 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (iii) Në çështjen civile nr. 931 rregj datë rregjistrimi 15.04.2016 me objekt të padisë «*Dëmshpërblim nga zgjidhja e kontratës së punës*», përfunduar me vendimin nr. 849 datë 18.07.2016. Referuar shenimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 26.07.2016, pra 8 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (iv) Në çështjen familjare nr. 1293 rregj datë 10.08.2015 me palë paditëse F.E vs Z.E me objekt të padisë «*Zgjidhje martese*», përfunduar me vendimin nr. 1206 datë 20.11.2015. Referuar shenimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 07.12.2015, pra 16 ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (v) Në çështjen penale nr. 490 rregj datë 09.09.2014 që i përket të pandehurit N.Demaj akuzuar për veprën penale të «*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive*» parashikuar nga neni 280 i K.Penal sipas të dhënave, rezulton se data e rregjistrimit është 09.09.2014 dhe data e përfundimit të çështjes 27.10.2014. Referuar shenimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 04.11.2014, pra 8 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (vi) Në çështjen penale nr. 717/103 rregj datë rregj 24.12.2015 ndaj të pandehurit A.Mollaj akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Ndërtimit të paligjshëm*” parashikuar nga neni 199/a/1 i K.Penal, sipas të dhënave rezulton se data e rregjistrimit është 24.12.2015 dhe data e përfundimit të çështjes 03.03.2016. Referuar shenimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton

se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 15.03.2016, pra 12 ditë nga shpallja e vendimit, tejkalim 2/ditor që konsiderohet i papërfillshëm.

KONKLUZIONI

Sa më sipër analizuar si në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, ashtu edhe nga të dhënat e sipërcituara në lidhje me dosjet e shortuara, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimeve për çështjet e kategorisë “penale” është 6.4 ditë, për kategorinë “civile themeli” 8.5 ditë, për kategorinë “marrëdhënie pune” 6 ditë dhe për kategorinë e çështjeve “familjare me palë kundërshtarë” 18 ditë. Në tërësi koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për shumicën e kategorive të çështjeve*”. Pavarësisht analizës matematikore, referuar asaj logjike ku vlerësuesi mban në konsideratë afatin 8/ditor të tejkalimit, faktin se ky tejkalim i afatit të arsytimit të vendimeve konstatohet vetëm në një kategori çështjesh (familjare) si dhe referuar edhe ngarkesës në punë të gjyqtarës, duke aplikuar koeficientin 20% të rritjes me 1 shkallë pikëzimi, për këtë kriter gjyqtarja pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Rferuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCEVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga Inspektorati i KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka kryer veprimet e nevojshme me qëllim përfundimin në kohë të gjykimit të çështjeve. Pas marrjes së çështjes me short ajo ka vënë në lëvizje shpejt përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore*

apo gjyqësore dhe njoftimin e palëve brenda afatit 10 ditor të përcaktuar nga neni 333 i K.Pr.Penale si dhe nenit 155 të K.Pr.Civile. Në 1 rast seanca e parë penale është caktuar pas 3 dite nga rregjistrimi në gjykatë, për rrjedhim nuk është respektuar afati 10 ditor i caktimit dhe njoftimit të palëve për seancën e parë gjyqësore sipas nenit 333 të K.Pr.Penale, shkaku nuk justifikohet dhe çështja nuk i përket natyrës urgjente (shih dosja nr. 4), Gjyqtarja ka disponuar me vendim formal për kalimin e çështjes për veprime apo seancë gjyqësore. Ndër 5 çështjet e vëzhguara, 2 prej tyre ka përfunduar me 1 seancë (shih dosjet nr. 1 dhe 4), 1 çështje me 5 seanca (shih dosjen nr. 2), 1 çështje me 6 seanca (shih dosjen nr. 5), 1 çështje me 7 seanca (shih dosjen nr. 3). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 20 seanca të zhvilluara prej tij, mesatarisht 4 seanca për çdo çështje. 13 prej këtyre seancave kanë qenë produktive, ndërsa 7 seanca ose 35 % e tyre kanë qenë joproduktive. Pengesë në 7 seanca joproduktive janë bërë; mungesa e gjyqtarës për shkaqe shëndeti në 2 raste (shih dosja nr. 5) mungesa e të paditurit në 1 rast (shih dosja nr. 5) në 1 rast mungon prokurori (shih dosja nr. 2), në 1 rast seanca është e përsëritur dhe nuk kuptohet se për çfarë shkaku (shih dosja nr. 2), në rast dite pushimi zyrtar (shih dosja nr. 3). Kërkesa e mbrojtësit për tu njohur me çështjen në 1 rast (shih dosjen nr. 1)”.

Gjyqtarja {...} në tërësi respekton afatet ligjore në caktimin e seancave, duke mbajtur në konsideratë edhe shkaku që shtyn seancën gjyqësore. Nga verifikimi i seancave gjyqësore është konstatuar 1 seancë e caktuar në shkelje të afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 201 i K.Pr.Civile për sigurimin e padisë (shih dosja nr. 3). Në çështjet civile seancat janë caktuar në afate të arsyeshme nga njëra tjetra (shih dosja nr. 1, 2 dhe 4). Seancat gjyqësore në tërësi nuk janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe me regjistrim audio, në funksion të solemnitetit dhe të transparencës së gjykimit dhe shkaqet nuk relatohen për cdo rast (shih dosjet nr. 2, 3 dhe 5). Në çeljen e seancave ka patur 9 vonesa nga 11 minuta (shih dosja nr. 2) deri në 1 orë e 10 minuta (shih dosja nr. 5). Shkaku kryesor për vonesën citohet gjykimet e mëparshme të gjyqtarës apo sallat e zëna të gjykimit. Vonesa nuk ka sjellë pasoja për gjykimin e çështjes. Në 1 rast seanca ka filluar 30 minuta para orarit të caktuar e cila ka sjellë si pasojë dështimin e seancës për shkak të mungesës së palës paditur (shih dosja nr. 5). Pavarësisht këtyre mangësive, duhet evidentuar se ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, në asnjë rast çështja e gjykuar prej saj nuk është kthyer për rigjykim për shkelje të procedurave gjyqësore.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 10 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtarë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, me përjashtim të dosjes nr. 1 që i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake:

- Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

Subjekti i rivlerësimit {...} ka kryer veprimet e nevojshme me qëllim përfundimin në kohë të gjykimit të çështjeve. Pas marrjes së çështjes me short ajo ka vënë në lëvizje shpejt përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore dhe njoftimin e palëve brenda afatit 10 ditor të përcaktuar nga neni 333 i K.Pr.Penale si dhe nenit 155 të K.Pr.Civile. Në 1 rast seanca e parë penale është caktuar pas 3 dite nga rregjistrimi në gjykatë, për rrjedhim nuk

është respektuar afati 10 ditor i caktimit dhe njoftimit të palëve për seancën e parë gjyqësore sipas nenit 333 të K.Pr.Penale. Nga ana tjetër ky fakt nuk rezulton të ketë sjellë pasoja pasi i pandehuri ka qënë i pranishëm në gjykim dhe nuk ka shfaqur pretendime të kësaj natyre (shih dosjen 4). Gjyqtarja ka disponuar me vendim formal për kalimin e çështjes për veprime përgatitore/ pajtimi apo seancë gjyqësore. Ndër 5 çështjet e vëzhguara, 2 prej tyre ka përfunduar me 1 seancë (shih dosjet nr. 1 dhe 4 - çështje penale themeli dhe caktim mase sigurimi), 1 çështje me 5 seanca (shih dosjen nr. 2), 1 çështje me 6 seanca nga të cilat 3 seanca përgatitore dhe 3 seanca gjyqësore (shih dosjen nr. 5), 1 çështje me 7 seanca gjithsej nga të cilat 3 seanca përgatitore dhe 4 seanca gjyqësore (shih dosjen nr. 3). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 20 seanca të zhvilluara prej saj. Në përgjithësi seancat kanë qënë produktive. Shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore në përgjithësi ka qënë për shkaqe procedurale por jo vetëm si; mungesa e gjyqtarës për shkaqe shëndeti në 2 raste (shih dosja nr. 5) mungesa e të paditurit në 1 rast (shih dosja nr. 5) në 1 rast mungon prokurori (shih dosja nr. 2), në rast dite pushimi zyrtar (shih dosja nr. 3). Gjyqtarja {...} në tërësi respekton afatet ligjore në caktimin e seancave, duke mbajtur në konsideratë edhe shkaku që shtyn seancën gjyqësore. Në çështjet civile seancat janë caktuar në afate të arsyeshme nga njëra tjetra (shih dosja nr. 1, 2 dhe 4). Seancat gjyqësore pjesërisht janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe me regjistrim audio, kjo për shkak edhe të pamundësisë së sallave të gjykimit (shih dosjet nr. 2, 3 dhe 5). Në çeljen e seancave ka patur disa vonesa të cilat variojnë nga 11 minuta (shih dosja nr. 2) deri në 1 orë e 10 minuta (shih dosja nr. 5). Shkaku kryesor për vonesën citohet gjykimet e mëparshme të gjyqtarës apo sallat e zëna të gjykimit. Pavarësisht këtij fakti, vonesat asnjëherë nuk kanë sjellë pasoja për gjykimin e çështjes. Në tërësi, gjyqtarja ka mbikëqyrur kryerjen e njoftimeve nga sekretaria gjyqësore, ndërsa shtyrjet e gjykimeve për njoftimin e tyre ka ndodhur për shkaqe procedurale.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

Në 2 çështjet penale (penale krime dhe kundravajte penale) rezulton se numri i seancave të zhvilluara nga ana e gjykatës është 3 seanca gjyqësore (dosja 6 dhe 7).

Tek dosja 6, Çështja është vënë në lëvizje nga relatorja e çështjes duke caktuar seancën e parë gjyqësore konform nenit 333 të K.Pr.Penale dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve për ditën dhe orën e gjykimit. Aktet e njoftimit me shkresë për shoqërimin e të pandehurit dhe njoftimin për organin e akuzës janë pjesë e dokumentacionit të dosjes. Janë zhvilluar gjithsej 3 (tre) seanca gjyqësore të cilat vetëm 2 (dy) kanë rezultuar produktive, pasi seanca e parë gjyqësore nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjykatës për arësye shëndetësore. Gjykimi ka zgjatur 2 (dy) muaj dhe 9 (nëntë) ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD-së. Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari, duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe në çdo rast brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar në nenin 342/2 të K.Pr.Penale.

Tek dosja 7, Çështja është vënë në lëvizje nga relatorja e çështjes duke caktuar seancën e parë gjyqësore konform nenit 333 të K.Pr.Penale dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve për ditën dhe orën e gjykimit. Aktet e njoftimit me shkresë për shoqërimin e të pandehurit dhe njoftimin për organin e akuzës janë pjesë e dokumentacionit të dosjes. Janë zhvilluar gjithsej 3 (tre) seanca gjyqësore, 2 (dy) nga të cilat kanë rezultuar produktive. Gjykimi ka zgjatur 1 (një) muaj dhe 18

(tetëmbëdhjetë) ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale konform vendimit 261/2 të KLD-së. Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtari, duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe në çdo rast brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar në nenin 342/2 të K.Pr.Penale. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar vetëm 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 (dy) nuk janë rregjistruar me sistemin audio, por janë dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

Në 4 (katër) çështjet civile (*civile themeli dhe familjare me palë kundërshtare*) rezulton se numri i seancave të zhvilluara nga ana e gjykatës është i ndryshëm, nga 1 (një) seancë gjyqësore (shih dosjen 9) në 3 seanca gjyqësore (shih dosjen 6, 7 dhe 8) dhe në 6 (gjashtë) seanca gjyqësore (shih dosjen 10), kjo duke u nisur edhe nga kompleksiteti i gjykimit.

Në dosjen 8, Çështja është regjistruar në muajin gusht (muaj i pushimeve vjetore për gjykatën) dhe me shortin e datës 02.09.2015 i është caktuar gjyqtarës {...} në cilësinë e kryesueses/relatores së çështjes. Me vendimin e datës 10.09.2015 çështja është vënë në lëvizje nga relatorja e çështjes duke caktuar seancën e pajtimit konform nenit 134 të K.Familjes më datë 01.10.2015 ora 09.00 dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve për ditën dhe orën e seancës së pajtimit. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 1 (një) seancë pajtimi dhe 3 (tre) seanca gjyqësore, 1 seancë gjyqësore nuk rezulton që të jetë rregjistruar me sistemin audio por dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur nga sekretarja gjyqësore. Pasi është ezauruar seanca e pajtimit gjykata ka proceduar me kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Janë zhvilluar gjithsej 3 (tre) seanca gjyqësore të cilat kanë rezultuar seanca produktive. Gjykimi ka zgjatur 3 (tre) muaj dhe 10 (dhjetë), brenda standardit minimal kohor prej 4 muajsh për gjykimet familjare me palë kundërshtare konform vendimit 261/2 të KLD-së. Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja, duke përfunduar në një afat të shkurtër. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra.

Tek dosja 9, Çështja është vënë në lëvizje brenda 7 ditëve nga momenti i caktimit me short të çështjes duke caktuar seancën e parë përgatitore konform nenit 158/a të K.Pr.Civile si dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve për ditën dhe orën e seancës përgatitore. Pas zhvillimit të seancës përgatitore në të cillën gjykata pasi ka dëgjuar shpjegimet e palëve dhe ka kuptuar natyrën e mosmarrëveshjes, dhe pasi ka konstatuar se padia është pa të meta dhe çështja e plotë dhe është kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje ka marrë vendim të nërmjetëm për të kaluar çështjen në seancë gjyqësore konform nenit 158/a dhe 171/a të K.Pr.Civile. Për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë përgatitore dhe 1 (një) seancë gjyqësore të cilat nuk janë rregjistruar me sistemin audio por janë dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur nga sekretarja gjyqësore. Është zhvilluar gjithsej 1 (një) seancë gjyqësore seancë e cila ka rezultuar produktive duke qënë se çështja është zgjidhur me vendim përfundimtar. Gjykimi ka zgjatur 2 (dy) muaj dhe 24 (njëzet e katër), pra brenda standardit minimal kohor për gjykimet civile me palë kundërshtare konform vendimit 261/2 të KLD-së.

Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja, duke e përfunduar relativisht brenda një afati të arësyeshem. Pavarësisht faktit se seanca gjyqësore nga ajo përgatitore është lënë në një afat prej 1 muaji distancë nga njëra - tjera, rezulton që çështja është menaxhuar mirë nga ana

e gjyqtares duke qënë se është zhvilluar vetëm një seancë e cila ka përfunduar edhe me dhënien e vendimit përfundimtar.

Në dosjen 10, Çështja është vënë në lëvizje nga relatorja e çështjes vetëm dy pas caktimit me short si relatores e çështjes duke caktuar seancën e parë përgatitore konform nenit 158/a të K.Pr.Civile dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve për ditën dhe orën e seancës përgatitore. Për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë përgatitore dhe 6 (gjashtë) seanca gjyqësore të cilat janë rregjistruar me sistemin audio dhe gjithashtu dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur nga sekretarja gjyqësore. Rezulton që pas ezaurimit të seancës përgatitore, gjykata ka nxjerë vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Janë zhvilluar gjithsej 6 (gjashtë) seanca gjyqësore të cilat përgjithësisht kanë rezultuar seanca produktive. Gjykimi ka zgjatur 2 (dy) muaj dhe 12 (dymbëdhjetë) ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimet civile me palë kundërshtare konform vendimit 261/2 të KLD-së. Rezulton që çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore janë për shkaqe procedurale në funksion të zhvillimit të gjykimit konform procesit të rregullt ligjor (*për të paraqitur palët ndërgjyqëse provat, për tu përfaqësuar me avokat pala paditëse*). Vetëm një seancë është shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues po për shkaqe të justifikuar (*rezulton që gjykata ka qënë në trajnim në Shkollën e Magjistraturës*).

Në dosjen 11, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtarja 4 ditë pas caktimit të saj si relatores e çështjes, duke caktuar seancën e parë përgatitore konform nenit 158/a të K.Pr.Civile. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 1 (një) seancë përgatitore dhe 3 (tre) seanca gjyqësore. Rezulton që pas ezaurimit të seancës përgatitore gjykata ka nxjerë vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Janë zhvilluar gjithsej 3 (tre) seanca gjyqësore të cilat kanë rezultuar seanca produktive. Shkaqet e shtyrjeve të seancave kanë qënë gjithmonë për shkaqe objektive në funksion të një procesi të rregullt ligjor. Rezulton që çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja. Seancat janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve të shkurtra dhe çështja ka përfunduar brenda standardit minimal kohor për gjykimet civile me palë kundërshtare konform vendimit 261/2 të KLD-së.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli dhe civile themeli) varion nga 1 deri në 6 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 3.5 seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare (duke përfshirë seancat përgatitore), 3 (tre) seanca gjyqësore në çështje penale themeli, dhe 3 (tre) seanca gjyqësore në çështjet familjare (duke përfshirë seanca e pajtimit), dhe në total numri mesatar i seancave është 3.2 seanca për të gjitha kateogritë e çështjeve. Ndërkohë nëse në lidhje me këtë kriter do të përlllogarisim edhe seancat gjyqësore (24 seanca) në çështjen civile për të cilën i është tërhequr vëmendja gjyqtares, atëherë numri mesatar i seancave gjyqësore në çështjet civile do të rritet ndjeshëm vetëm për shkak të kësaj çështje në 7.5 seanca gjyqësore në çështjet civile.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile dhe penale themeli me palë) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet

procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe neni 333 e vijues dhe 342/2 të K.Pr.Penale*). Në çështjet penale data e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10 ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale. Në 1 rast seanca e parë penale është caktuar pas 3 dite nga rregjistrimi në gjykatë, për rrjedhim nuk është respektuar afati 10 ditor i caktimit dhe njoftimit të palëve për seancën e parë gjyqësore sipas nenit 333 të K.Pr.Penale. Nga ana tjetër, ky fakt nuk rezulton të ketë sjellë pasoja pasi i pandehuri ka qënë i pranishëm në gjykim dhe nuk ka shfaqur pretendime të kësaj natyre. Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si njoftimit i të pandehurve, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurit, njoftimi i prokurorit, njoftimi i përsëritur për të paditurin në seancën e pajtimit (zgjidhje martese), marrje e informacionit dhe provave nga të tretët, kryerja e akteve të ekspertimeve, njoftimi i ekspertit etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, përveçse kur kjo ka qënë objektivist e pamundur (*për shkak të pushimeve në muajin Gusht*), por edhe në çështjet civile konstatohet se gjyqtarja cakton përgjithësisht seanca të afërta në kohë nga njëra – tjetra jo më shumë se 1 muaj larg.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve⁴⁷ të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është mbi 3 seanca, por nga ana tjetër gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3 (vetëm në çështjet civile), gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproductive.

⁴⁷ Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “*Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse*”.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3 vetëm për një kategori çështjesh, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Seancat gjyqësore në tërësi nuk janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe me regjistrim audio, në funksion të solemnitetit dhe të transparencës së gjykimit dhe shkaqet nuk relatohen për cdo rast (shih dosjet nr. 2, 3 dhe 5). Në çeljen e seancave ka patur 9 vonesa nga 11 minuta (shih dosja nr. 2) deri në 1 orë e 10 minuta (shih dosja nr. 5). Shkaku kryesor për vonesën citohet gjykimet e mëparshme të gjyqtarës apo sallat e zëna të gjykimit. Vonesa nuk ka sjellë pasoja për gjykimin e çështjes. Në 1 rast seanca ka filluar 30 minuta para orarit të caktuar e cila ka sjellë si pasojë dështimin e seancën për shkak të mungesës së palës paditur (shih dosja nr. 5).”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose deri në 7 ditë pas

caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, në përgjithësi mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Shkak i mos zhvillimit të të gjitha seancave gjyqësore me sistemin audio ka qënë për arsye administrative dhe funksionaliteti në Gjykatën pranë se cilës ka ushtruar funksionin gjyqtarja në periudhën e vlerësimit (për shkak të pamundësisë së zhvillimit të seancës gjyqësore në sallë). Pavarësisht këtij shkak, seancat të cilat nuk janë zhvilluar me sistemin audio janë dokumentuar me procesverbal gjyqësor me shkrim të mbajtur nga sekretarja gjyqësore,

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qënë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa 2 deri në 15 min që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë konstatohet edhe një numër seancash (9 seanca) të filluara me më shumë se 25 min deri në 1 orë e 17 minuta vonesë nga ora e planifikuar (1 seancë). Në tërësi pavarësisht fillimit me vonesë të disa prej seancave gjyqësore, të cilat rezultojnë në një përqindje të vogël në raport me seancat e analizuara (12% e seancave rezultojnë të filluara me vonesë) nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes. Shkak i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relativitetit të gjyqtarës lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, apo edhe në pritje të zhvillimit të seancës gjyqësore me sistemin audio duke qënë se sallat e gjykimit kanë qënë të zëna me gjykime të tjera. Distancat kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë.

KONKLUZIONI

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe

efiçensës së treguar nga gjyqtari në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Në 9/seancat e filluara me vonesë, referuar relatimit të gjyqtares, duket se kanë ndikuar kushtet e punës e infrastruktura e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ku në periudhën e vlerësimit kanë ushtruar detyrën 10/gjyqtarë, ndërkohë që ka pasur vetëm 3/salla gjykimi ku proceset regjistrohen në sistemin audio. Gjithashtu duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short përgjithsisht është konstatuar se gjyqtarja ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si akti formal i gjyqtares për kalimin e çështjes në seancë përgatitore apo gjyqësore, në dosje përfshihen kopjet e fletë thirjeve për palët ndërgjyqëse, për të dokumentuar datën e njoftimit për gjykim, procesverbali i seancave, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare të gjyqtares dhe të zbardhura nga sekretaria gjyqësore, provat, etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal, por në 4 raste mungon ora e mbylljes (shih dosja nr. 3). Në 5 dosjet e vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve procedurale dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke përmbajtur kërkesë padia, aktet e përfaqësimit të palëve, provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, njoftimet e palëve, diskutimet me shkrim të palëve, vendimin e kalimit të çështjes në seancë përgatitore, seancat përgatitore të zhvilluara sipas datave dhe me pas vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, procesverballi i seancës gjyqësore sipas datave, dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short përgjithësisht është konstatuar se gjyqtarja ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si akti formal i gjyqtarës për

kalimin e çështjes në seancë përgatitore apo gjyqësore, në dosje përfshihen kopjet e fletë thirjeve për palët ndërgjyqëse, për të dokumentuar datën e njoftimit për gjykim, procesverbali i seancave, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare të gjyqtarës dhe të zbardhura nga sekretaria gjyqësore, provat, etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal, por në 4 raste mungon ora e mbylljes (shih dosja nr. 3). Në 5 dosjet e vëzhguara janë inventarizuar aktet proceduriale.”

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, si dhe vendimi përfundimtar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve si prokura, autorizime, ekstrakte të rregjistrimit tregtar, provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i ekspertimit nëse është lejuar marrja e proves me ekspert, diskutimet përfundimtare të palëve, etj). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në lidhje me këtë tregues.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	97

4. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e hartuar te KLGJ-së, konkludohet se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “08 tetor 2013-08 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 3 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (2 në vitin 2015 dhe 1 ankesë në vitin 2016). 1 ankesë e vitit 2015 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se është ankesë e përsëritur. 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për zvarritje gjykimi, e cila është regjistruar gjyqtares për efekt të vlerësimi profesional dhe etik dhe « tërheqje vëmendje me shkrim » 1 ankesë e vitit 2015 është e përsëritur, 1 ankesë e vitit 2016 verifikuar për mosrepsketim formal të ligjit është sugjeruar mbajtja e saj në vijim deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta. Për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur një kërkesë nga Ministria e Drejtësisë për procedim disiplinor.⁴⁸”*

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLGJ nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pa bazuara.

Për periudhën e vlerësimit Tetor 2013 - Tetor 2016, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cënimit të etikës, pasi ato referohen vetëm si pretendime që zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, të cilat nuk përbëjnë burim më vete vlerësimi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që

⁴⁸Shih fq 32 te Raportit.

mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” shkalla e aftësisë është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e hartuar nga KLGJ, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.”*

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e hartuar nga KLGJ
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore që kanë lidhje me nderin dhe dinjitetin në ushtrimin e funksionit. Nga ana tjetër, sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “08 tetor 2013-08 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 3 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (2 në vitin 2015 dhe 1 ankesë në vitin 2016).1 ankesë e vitit 2015 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se është ankesë e përsëritur. 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për zvarritje gjykimi, e cila është regjistruar gjyqtares për efekt të vlerësimi profesional dhe etik dhe « tërheqje vëmendje me shkrim » 1 ankesë e vitit 2015 është e përsëritur, 1 ankesë e vitit 2016 verifikuar për mosrepsketim formal të ligjit është sugjeruar mbajtja e saj në vijim deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta. Për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur një kërkesë nga Ministria e Drejtësisë për procedim disiplinor.⁴⁹”.

⁴⁹Shih fq 32 te Raportit.

Referuar të dhënave në lidhje me praktikën e trajtimit të ankesave si më sipër rezulton se:

(i) Në datë 12.09.2015 me nr. 2948 prot është paraqitur një ankesë për zvarritje të gjykimit nga ankuesi Q. Koxhaj. Në datë 01.10.2015 me nr. 3086 prot është paraqitur përsëri një ankesë po nga ky shtetas për të njëjtën çështje dhe për të njëjtin shkak (zarritje të gjykimit). Nga ana e ish KLD-së është bërë bashkimi i kësaj ankesë të dytë të përsëritur me ankesën e parë nr. 2948 prot datë 12.09.2015.

(ii) Ankesa nr. 2098 prot datë 26.05.2016 për verifikim për mosrespektim formal të ligjit i është përcjellë ILD-së e rregjistruar pranë ILD me nr. 2815 prot datë 23.11.2020 e cila me vendimin nr. 4211/1 prot datë 25.11.2021 ka vendosur: Arkivimin e ankesës së av. A.B dhoma e avokatisë Tiranë”, me arsyetimin se pretendimet e ngritura në ankimin e ankuesit lidhur me aspekte e interpretimit të ligjit material janë rrëzuar nga gjykata më e lartë në kuadër të kontrollit gjyqësor e për pasojë ILD nuk mund të zëvendësojë organin gjyqësor e cënojë pavarësinë e gjyqësorit. Vendimet e gjyqtarit nuk mund të bëhen objekt rishikimi jashtë sistemit të apelimit, e në këtë aspekt rezultatet e verifikimit të kësaj ankesë janë të tilla që nuk afektojnë as në çështje të integritetit të gjyqtarës në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës.

(i) Në lidhje me ankesën nr. 2948 prot bashkuar me ankesën nr. 3086 prot, nga relatiimi datë 09.12.2015 mbi verifikimin e ankesës rezulton se: Ankuesi Q.Koxhaj ankohet për veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarës lidhur me zvarritjen e gjykimit të çështjes civile nr. 499/47 datë rregj 17.02.2014 me palë paditëse E.Cufe, palë e paditur K.Baze me objekt të padisë “*Lirim dhe dorëzim sendi*”. Pas verifikimit të ankesës nga ana e Inspektorëve të KLD-së ka rezultuar se: Çështja civile ka përfunduar për një afat prej 1 vit 8 muaj dhe 8 ditë nga ana e Gjyqtarës {...}. Po kështu rezulton që janë zhvilluar gjithsej 25 seanca nga të cilat 1 seancë përgatitore dhe 24 seanca gjyqësore. Sipas këtij relacioni rezulton se jo të gjitha shkaqet e shtyrjeve të seancave kanë qënë për arsye procedurale dhe në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor pasi 2 seanca janë shtyrë për shkak se gjykata ka vendosur të therrasë persona të tretë, 2 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak se ekspertja duhet të parapaguhet, 3 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarës, një rast feste, një rast seminar dhe një rast vdekje, 3 seanca janë shtyrë për shkak se gjyqtarja ka kërkuar informacion pranë institucioneve shtetërore si ZVRPP Skrapar dhe ZGJC Polican, dhe një seancë pasi gjyqtarja ka vendosur që të kryejë riekspertim. Nga ana e inspektorëve është konkluduar se : *...në rastin konkret çështja ka përfunduar tej afatit standard të përcaktuar (6 muaj sipas vendimit 261/2010 të KLD-së) dhe se çështja duhej të ishte menaxhuar më mirë nga ana e gjyqtarës duke shmangur shumë nga seancat joproductive. Konkretisht gjyqtarja duhej të kishte menaxhuar më mirë çështjen duke i lënë seancat më afër njëra-tjetrës, me qëllim që gjykimi të përfundonte brenda afateve, të merrte masa për njoftimin në kohë të të gjithë personave që janë palë e paditur apo persona të tretë., nuk është menaxhuar mirë rasti pasi nga ana e gjykatës janë bërë 2 akte ekspertimi. Po kështu referuar objektit të padisë duhet të kishte vepruar me më dilijencë për të kërkuar që në fillim nga institucionet e treta dokumentacionin e nevojshëm për një zhvillim të plotë dhe të gjithanshëm.*

Nga ana e KLD-së në përfundim është vendosur: *Tërheqje vëmendje për Gjyqtaren {...} lidhur me ankesën nr. 2984 prot datë 17.09.2015 për zvarritje gjykimi pasi afati i gjykimit është tejkaluar me 1 vit dhe 2 muaj.*

Në fakt referuar të dhënave të çështjes së mësipërme rezulton se çështja nuk ka përfunduar për një periudhë prej 1 vit 8 muaj dhe 8 ditë nga ana e gjyqtares {...}, kjo pasi edhe pse mban si datë rregjistrimi datën 17.02.2014, vetëm në datë 17.04.2014 i ka kaluar me short për gjykim gjyqtares {...}, pasi më parë ka qënë për shqyrtim tek një tjetër gjyqtare. Pra duke qënë se gjyqtarja {...} e ka marrë çështjen në datë 17.04.2014, që nga kjo datë duhet të ecin afatet standarte që merren në konsideratë për vlerësimin profesional. Çështja ka përfunduar me vendimin e datës 27.10.2015 pra, pas 1 vit dhe 6 muaj nga momenti i caktimit me short. Gjithashtu në ecjen e afatit të gjykimit të çështjes nuk duhet të përlllogaritet edhe periudha e pushimeve vjetore (në muajin Gusht 2014 dhe muajin Gusht 2015) të cilat e rrisin ndjeshëm edhe me 2 muaj të tjerë gjykimin e çështjes. Në këtë kontekst nëse do të zbresim edhe këto dy muaj do të rezultonte që çështja është përfunduar nga ana e gjyqtares {...} për një kohë prej 1 (një) vit, 4 (katër) muaj dhe 10 (dhjetë) ditë nga momenti i marrjes së kësaj çështje në short.

Pavarësisht se çështja e mësipërme ka përfunduar tej standardit minimal kohor, ajo rezulton të ketë qënë relativisht komplekse, pasi me dy kërkime për të cila nevojiteshin njohuri të posaçme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nga ana tjetër sjellja e palëve në proces është bërë shkak për shtyrjen e seancave, duke mos u paraqitur apo duke mos u treguar korrekt në zbatimin e rregullave procedurale (si psh në mos kryerjen dy herë radhazi të pagesës së aktit të ekspertimit). Gjyqtarja ka marrë masa për zbatimin e urdhrave të saj (duke vendosur *gjobë institucionit përkatës*) nga institucionet shtetërore. Nga ana tjetër evidentohet se ka pasur seanca të shtyra edhe për shkak të gjyqtares, por në tërësi mënyra e menaxhimit të çështjes gjyqësore me qëllim shqyrtimin e saj brenda një afati të arsyeshëm, janë elementë që në rastin konkret nuk afektojnë treguesin e integritetit profesional të gjyqtares, përveç atyre të konstatuara dhe analizuara në lidhje me treguesit e aftësive organizative për këtë periudhë vlerësimi.

- Nga vendimin nr. 400 datë 25.06.2021 të KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se “Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit”.

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pa bazuara duke konkluduar se: “Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.”

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cënim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” shkalla e aftësisë është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për gjyqtaren {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumentave ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nëvojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentat ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se; “.. në dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin nga gjykimi i çështjeve.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (*burimet arkivore të KLD/KLGJ*) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (*11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja*) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e

Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar te palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër është si “i pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, marrjen e provave nga të tretët, etj*) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cënim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e hartuar nga KLGJ konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Duhet evidentuar se nuk ka patur seanca gjyqësore të dështuar nga planifikimi për shkaqe të organizimit të trupit gjykues apo stafit administrativ, por 2 prej tyre kanë dështuar për shkak të gjëndjes shëndetësore të gjyqtarës (shih dosja nr. 5). Subjekti i rivlerësimit ka qënë pjesë e një trupi gjykues të formuar me 1 gjyqtar (shih dokumenti nr. 2, 3 dhe dosja nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5) dhe me tre gjyqtarë në 1 rast (shih dokumenti nr. 1). Në 2 raste është konstatuar vonesë në arsyetimin e vendimit dhe depozitimim e dosjes gjyqësore në sekretari (shih dosja nr. 4 dhe 5).”

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave si më sipër relatuar, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, vlerësohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit

(gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social etj, duhet të vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, vlerësohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ dhe vërtetimit nr. 552/1 prot, datë 25.10.2016, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës gjyqtarja ka marrë pjesë në 14 trajnime në 25 ditë për 3 vjet, të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9⁵⁰ të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e trajnerit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si trajner e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës tre vjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 25 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit nga të cilat 25 ditë trajnim si pjesëmarrëse.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës civile, penal, familjare etj, gjithsej 14 aktivitete të zhvilluara për 25 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve ligjore 15-120 ditë, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

⁵⁰Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se: “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë qënë e angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} , duke qënë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të mos jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësuese pranë Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

**4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-
INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI
PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë kriter.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në

varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë kriter.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën e vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI
DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	97	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	388	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...} PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013 - 2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE			
Treguesit		Burimet	Niveli
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose	<ul style="list-style-type: none">▪ Dosja e rivlerësimit;▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas	Shumë e lartë

	konfliktin e normave	fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE

Tregues		Burimet	Niveli
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	11-20 %
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të 	Më e shkurtër ose e barabartë

		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Mbi 93-99 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> b. Dosja e rivlerësimit; c. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë

	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	c. Dosja e rivlerësimit; d. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	Shumë e lartë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE			
Tregues		Burimi	Niveli
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	I pa konsiderueshëm
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL			
Tregues		Burimi	Niveli
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	15-120 ditë

	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimi ligjore akademike	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna
NIVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT		SHKËLQY	
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		388	

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR